"Shërbimet " : janë aktivitet e përcaktuara në këto specifikime teknike që lidhen me menaxhimin , vlerësimin e kushteve të rrugës dhe punimet e mirëmbajtjes që do kryhen nga Kontraktuesi

"Mirëmbajtja" : përfshinë aktivitetet e mirëmbajtjes së autoudhës A7, A6 dhe rrugës nacionale N9 (SEGMENTI : Bresje – Gjurgjicë) , për të siguruar komunikacion të sigurt dhe pa pengesa në të gjitha kushtet atmosferike dhe rasteve të jashtë zakonshme .

"Qëllimi i Mirëmbajtjes " : Mirëmbajtja Autoudhës A7, A6 dhe rrugës Nacionale N9, duke përfshirë edhe strukturat dhe kyqjet në Autoudhë , me qëllim të ruajtjes së Auto udhës sa më afër që është e mundur , gjendjes kur ajo është ndërtuar dhe sigurimit të zhvillimit të komunikacionit pa pengesa .

"Strukturat": përfshijnë strukturat (urat , mbikalimet , nënkallime etj në Autoudhë), zonat e parkingjeve, zonat e serviseve , Qendrat e Mirëmbajtjes dhe të Koordinimit si dhe objektet tjera të cilat janë konsiderohen të domosdoshme të mirëbahen .

"Nivelet e Cilësisë së Shërbimit": janë standarde të kërkuara punimesh të përcaktuara në Specifikimet teknike të cilat Kontraktuesi do ti përmbahet gjatë zbatimit të Kontratës së mirëmbajtjes .

"Menaxheri i Projektit" : (nga punëdhënësi) është person autorizuar dhe i caktuar nga punëdhënësi i cili është përgjegjës për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e punimeve, aprovimin e sasive dhe pagesave për shërbimet e kryera nga kontraktuesi , sipas kushteve të kontratës .

"Menaxheri i Projektit": (nga kontraktuesi) është person i caktuar nga Kontraktuesi i cili është përgjegjës për menaxhimin e të gjitha aktiviteteteve të Kontraktuesit , për përmbushjen e kontratës .

Incident : Rast i jashtë zakonshëm - aksidentet e komunikacionit , vërshimet , erodimet e dheut , dëmtime në trupin e rrugës etj.

"Punët urgjente" : janë një grup i aktiviteteteve të nevojshme për të rivendosur Auto udhën A7,A6 dhe rrugën Nacionale N9 në nivel që komunikacioni të zhvillohet pa pengesa.

"Klienti " : Nënkupton – Punëdhënësin – Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit.

"Rruga që Mirëmbahet " : Autoudha A7, A6 dhe rruga Nacionale N9, duke përfshirë edhe strukturat dhe kyqjet në Autoudhë me rrugët e kryqzimeve dhe rrugët kyqëse .

Një km e Autoudhës përfshinë tërë profilin e Autoudhës (të dy drejtimet - anët e Autoudhës) , rrugët kyqëse (Kryqëzimet) në Autoudhë , strukturat dhe objektet që janë në funksion të mirëmbajtjes së Autoudhës dhe shërbimeve

3. Sfondi i Shërbimeve të Mirëmbajtjes

3.1 Sfondi i shërbimeve të mirëmbajtjes përfshijnë , Operimin dhe Mirëmbajtjen e Auto udhës R7 dhe R6 (segmentet e cekura në specifikimet teknike) dhe rrugës Nacionale N9 , ashtu siç është dhënë në Përshkrimin e punëve dhe kërkesave në këto specifikime teknike dhe në dosjen e tenderit.

3.2 Plani i Operimit

Ofertuesi duhet të ofrojë planin gjithëpërfshirës të shërbimeve të mirëmbajtjes . Plani duhet të bazohet në minimumin e pritur të kërkesave për Mirëmbajtje duke mbuluar të gjitha aspektet e mirëmbajtjes së Auto udhës (A7,A6) dhe rrugës Nacionale N9.

Si minimum, plani duhet të përmbajë:

Planin e mirëmbajtjes efektive të Autoudhës(A7,A6) dhe rrugës Nacionale N9 duke përfshirë të gjitha aktivitetet të Kontraktuesit , sipas kërkesave të përcaktuara në këto specifikimet teknike dhe dosjen e tenderit .

Të paraqet, mbajë dhe implementoj Planin e Zënies së Autoudhës dhe rrugës N9(gjatë rasteve të jashtë zakonshme - aksidentet , vërshimet , erodimet e dheut , dëmtime në trupin e rrugës etj , për të paraqitur Proceset dhe Procedurat e Ofruesit (të shërbimeve) për Menaxhimin e Zënies së Auto udhës(mbylljet e korsive të nevojshme për mirëmbajtje).

Të krijojë dhe të mirëmbajë linja të rregullta të komunikimit me Menaxherin e projektit (mbikëqyrësin) autoritetet vendore, reaguesit dhe palët tjerë ndaj incidentit.

Të paraqet, mbajë dhe implementoj Planin për Motin e Keq për të paraqitur Proceset dhe Procedurat e Ofruesit (të shërbimeve) ndaj Motit të Keq.

Të paraqet, mbajë dhe implementoj Planin për Kërkesat për Mirëmbajtje (PKM) lidhur me Drenazhin, Rrethimin me Gardh, Ndriçimi dhe Komunikimet, mirëmbajtjes së Zonave të Shtruara me Asfalt, Shenjat e Trafikut , Rrethojave me Gardh për Siguri, Kërkesat e Mirëmbajtjes së Peizazhit, kërkesat e Mirëmbajtjes së strukturave.

Planin e Operimit gjatë sezonës Dimrore (më detalisht do të ipet në pjesën e Mirëmbajtjes Dimrore).

Krijimin dhe mirëmbajtjen e databazës për Autoudhën që e mirëmbanë .

3.3 Kërkesat e përgjithshme për Mirëmbajtje

OE që oferton , duhet të bëjë inspektimin e Vendit (Autoudhës A7,A6 dhe rrugës N9, para dorëzimit Ofertës , për të marrë informata të nevojshme për ofertim.

Autoudha ,A7, A6 dhe rruga N9 do të mirëmbahen ashtu që të jenë ,hapur 24 orë/në ditë dhe çdo ditë të vitit, andaj dhe kontraktuesi për mirëmbajtje duhet të siguroj staf dhe mekanizim përkatës për mirëmbajtje edhe gjatë natës .

Shërbimet e kontraktuesit për mirëmbajtje do të përfshijnë mirëpo jo dhe domosdo të kufizohen në detyrat në vijim:

të ndërmarr të gjitha masat, për të siguruar që interesat e klientit të paraqiten në mënyrë të duhur në tërë aktivitetet dhe vendimet në lidhje me mirëmbajtjen e Autoudhës A7,A6 dhe rrugës N9.

Të ndërmarr të gjitha hapat e nevojshëm, për t'i parashikuar problemet dhe të tentoj të ndërmerr veprime drejt zgjidhjes së tyre në dobinë më të mirë të klientit ;

të merr të gjitha masat për t'i kryer tërë shërbimet e kontraktuara , për mirëmbajtje në pajtim me oraret e dhe afatet e përcaktuara , sasinë dhe cilësinë e kërkuar të punimeve .

Aty ku klienti kërkon, do të caktoj takime dhe sipas nevojës do të bëj të gjitha përpjekjet e arsyeshme për t'u siguruar që të gjitha palët relevante janë këshilluar në lidhje me takimet dhe që pjesëmarrja e tyre është e kërkuar;

të informoj për ecurinë dhe progresin e shërbimeve të mirëmbajtjes gjatë takimeve dhe të identifikoj kërkesat për informata. Të përgatis dhe shpërndaj procesverbalin për të gjitha palët e duhura;

bëj të gjitha përpjekjet e arsyeshme për t'i siguruar informacionet e kërkuara nga klienti për vet klientin dhe/ose ndonjë palë tjetër;

azhurnoj oraret e tërë aktiviteteve dhe ngjarjeve të rëndësishme gjatë shërbimeve të mirëmbajtjes, sipas nevojës;

të ruaj një set komplet të tërë korrespondencës, procesverbaleve nga mbledhjet dhe çdo dokumentacion tjetër me rëndësi në lidhje me projektin të lëshuara nga ose për kontraktuesin për mirëmbajtje.

Të mbajë dokumentacionin e tillë në dispozicion për inspektim nga klientit dhe të sigurojë kopje të tyre sipas kërkesës së klientit ;

ndjek takimet e caktuara nga klienti me vet klientin ose personat me të cilët klienti kërkon të takohet për të vënë në progres cilindo aspekt të projektit;

monitoroj parametrat e realizimit siç janë rreziku, koha, çmimi dhe cilësia dhe t'ia paraqes klientit vërejtjet e hershme rreth të gjitha çështjeve që mund të kenë ndikim në kohën, çmimin dhe cilësinë e shërbimeve të mirëmbajtjes .

merr aprovimin e klientit sipas nevojës në pajtim me procesin e aprovimit të klientit me të cilin kontraktuesi për mirëmbajtje është i njoftuar;

raportoje rregullisht tek klienti mbi statusin e projektit dhe t'i siguroj të gjitha vendimet e nevojshme.

4.Shërbimet e mirëmbajtjes

4.1 Mirëmbajtja Rutinore

MIRËRMBAJTJA RUTINORE E RRUGËVE PËRFSHINË:

Mirëmbajtja rutinore përbëhet nga aktivitetet ditore dhe aktivitetet periodike të cilat janë të domosdoshme për mirëmbajtjen e rrugës, strukturave pajisjet e Auto udhës dhe rrugës N9.

Punët e mirëmbajtjes rutinë , janë :

Inspektimi i rrugës , sinjalistikës , pajisjeve , objekteve për largimin e ujërave dhe strukturave etj.

Pastrimin e shtresave qarkulluese , bankinave , brezit ndarës të Autoudhës, pjerrësive , pajisjes dhe sinjalistikës,objekteve për largimin e ujërave , Rrethojës , Instalimeve Elektrike dhe objekteve për pastrimin e ujërave (Seperator dhe Laguna).

Eliminimin e rrjedhjeve të një situatë emergjente në Autoudhën dhe rrugën N9. .

Prerja e barit dhe shkurreve .

Mirëmbajtja e sinjalistikës (ndrrimi i shenjave dhe pajisjes së rrugës).

Riparimi i objekteve për largimin e ujërave (kanaleve të dheut , lëshesave , pusetave , drenazhave etj.)

Rregullimi i bankinave dhe brezit ndarës (plotësimi , nivelizimi dhe largimi i materialit të tepërt).

Sanimi i dëmtimeve lokale të pjerrësive dhe humusimi i sërishëm .

Largimi i materialit të Eroduar.

Riparimi dhe ndërimi i skajorëve nga betonit. Riparimi dëmtimeve në shtresat e asfaltit (gropat ,plasaritjet gjatësore dhe tërthore , grryerja e shtresave me makinë speciale , , denivelimet etj.).

Riparimet e vogla te strukturat .

Riparimet e rrjetave dhe gardhit të Autoudhës dhe rrugës N9 .

Riparimet e instalimeve Elektrike.

Punët tjera , si shtresimi dhe rindërtimi

Aktivitetet e shënuara në kuadër të mirëmbajtjes të rregullt do të realizohen vazhdimisht. Ndryshimet stinore gjatë vitit janë gjithashtu faktor ndikimi për të vendosur mbi radhën e prioritetit të punëve mirëmbajtëse.

Kontraktuesi për mirëmbajtje duhet t'i caktojë procedurat për orarin e punës. Sugjerohen grupimet e mëposhtme:

Grupi – I: Punimet, përfundimi i të cilave kërkon kohë të shkurtër (deri në 1 javë)

Grupi – II: Punimet, përfundimi i të cilave kërkon kohë më të gjatë (mbi 1 javë).

Në rast të ndonjë urgjence, duhet të ndërmerren veprime të menjëhershme për t'i mënjanuar bllokadat nga rruge, të ndërtohen devijime të përkohshme ose të ndërmerren masa urgjente parandaluese për të zvogëluar rritjen e dëmtimeve të parashikuara ose të bëhen veprimet parandaluese për menaxhimin e emergjencave.

Kontraktuesi për mirëmbajtje duhet t'i caktojë procedurat e menaxhimit të punës. Suksesi i sistemit për mirëmbajtjen e kontratës qëndron në menaxhimin e mirë të punës. Kontraktuesi për mirëmbajtje do t'i hartojë aktivitetet që duhet të realizohen nga ana e ekipit të vet si dhe pjesën e punës që do të kryhet nga ana e nënkontraktuesve.

Të bëhet dorëzimi i raporteve mbi mirëmbajtjen për secilën komponentë të punimeve.

Pajisja me mekanizim të mjaftueshëm , staf dhe personel ndihmës mjaftueshëm duke përfshirë planin gjithëpërfshirës dhe metodologjinë e realizimit të mirëmbajtjes , sipas kërkesave të dhëna në këto specifikime teknike.

Testimi I të gjitha materialeve dhe punimeve nga një laborator i Licencuar . Shpenzimet për testet e nevojshme për kontrollim të cilësisë që do të kryhen nga kontraktuesi për mirëmbajtje (Nga ndonjë Laborator ose Kompani e Licencuar për ekzaminimin e materialeve dhe cilësisë së punimeve) . Shpenzimet për testet do t'i bartë vet kontraktuesi dhe konsiderohen se janë të përfshira në çmimet njësi të punëve të përcaktuara në paramasën dhe ofertën e kontraktuesit (OE). Punimet dhe aktivitetet duhet të planifikohen dhe të realizohen në mënyrën që siguron siguri publike me riparimet e dëmtimeve të vogla dhe duke e mirëmbajtur Auto udhën e rrugën N9 në kushtet e nevojshme dhe të realizoj mirëmbajtje të pa planifikuar të shkaktuar nga ngjarjet e jashtëzakonshme, sikur që janë aksidentet, fatkeqësitë natyrore, kushtet e jashtëzakonshme të motit dhe të ngjashme.

kontraktuesi për mirëmbajtje do t'i sigurojë punëdhënësit disponueshmëri maksimale dhe përdorim efikas të aseteve. Kjo gjithashtu përfshinë mbrojtjen e të drejtës nga cenimet dhe aktivitetet tjera të pa autorizuara. Për këtë qëllim, kontraktuesi për mirëmbajtje do të hartojë një regjistër të plotë të aseteve që do të mirëmbahet dhe azhurnohet në vazhdimësi .

çdo dëmtim ose humbje e aseteve siç janë shenjat, përvijimet, tabelat, etj. qoftë si pasojë e vjedhjes ose e neglizhencës së kontraktuesit për mirëmbajtje, do të kompensohet plotësisht nga kontraktuesi për mirëmbajtje. Tërë aktivitetet mirëmbajtëse do të realizohen në pajtim me veçoritë relevante të përshkruara në këto specifikime dhe kontratë.

kontraktuesi për mirëmbajtje do të mbajë kontakte të rregullta me të gjitha institucionet dhe agjencitë relevante (p.sh. ekipet e shpëtimit, zjarrit, për materiale të rrezikshme, ato të komunikacionit, policisë, ambulancën, spitalet, ekipet për pastrim etj.). Kontraktuesi, do të mbajë përgjegjësi për kontakte dhe koordinim me këta përfaqësues në emër të punëdhënësit.

qendra për menaxhim të incidenteve do të operojë (me personel) gjatë 24 orëve.

kontraktuesi për mirëmbajtje do të mirëmbajë regjistrat e detajeve të tërë incidenteve.

incidenti fatal që për pasojë ka humbjen e jetës ose lëndimet e rënda, periudha të gjata të mbylljes së rrugës, ose punime madhore për rehabilitimin e rrugës, do të hartohet një raport mbi incidentin i cili do t'i dorëzohet menaxherit të projektit dhe punëdhënësit brenda pesëmbëdhjetë ditëve pas çdo ngjarjeje.

kontraktuesi për mirëmbajtje do të mbajë shënime të makinave të larguara për shkak të aksidentit ose dëmtimit duke i fotografuar ato me kohë dhe do t'ia dorëzojë punëdhënësit raportin mujor.

kontraktuesi për mirëmbajtje do të mënjanojë kafshët/zogjtë e ngordhur nga rruga dhe do t'i varrosë ato brenda dy orëve pasi të ketë ndodhur incidenti.

do të bëhet inspektimi i plotë dhe i tërësishëm i seksionit të Auto udhës dhe rrugës N9, gjatë intervaleve të përshtatshme sikurse përshkruhen në specifikimet teknike.

Kontraktuesi për mirëmbajtje do të sigurojë pajisje të përshtatshme testuese për inspektim cilësor.

kontraktuesi për mirëmbajtje duhet të përcaktoj procedurën për planifikimin e programit të mirëmbajtjes për t'i identifikuar aktivitetet e mirëmbajtjes, që duhet të ndërmerren menjëherë. Pas 7 (shtatë) ditëve që kryhet inspektimi. Punimet e identifikuar do të shqyrtohen me kujdes dhe të përcaktohen.

kontraktuesi për mirëmbajtje duhet të themelojë procedurën për identifikimin e prioriteteve.

Punimet e përsëritura: si pastrimi dhe riparimi i sipërfaqeve, pastrimi i kanaleve pas shiut, riparimet e pjerrësive të skarpateve, mbyllja lokale dhe riparimi i gropave në shtresat qarkulluese.

Punimet periodike: si riparimi i anësoreve, riparimi madhor i pjesëve të dëmtuara të rrugës, shënuesit e sipërfaqes mbi rrugë, rimbyllja dhe riparimi i drenazhit dhe objekteve për largimin e ujërave atmosferik. - Punimet tjera periodike: si shtresimi dhe rindërtimi.

kontraktuesi për mirëmbajtje duhet t'i caktoj procedurat e menaxhimit të punës. Suksesi i sistemit për mirëmbajtjen e kontratës qëndron në menaxhimin e mirë të punës. Kontraktuesi për mirëmbajtje do t'i hartojë aktivitetet që duhet të realizohen nga ana e ekipit të vet si dhe pjesën e punës që do të kryhet nga ana e nënkontraktuesve.

punimet dhe aktivitetet duhet të planifikohen dhe të realizohen në mënyrën që siguron siguri publike me riparimet e dëmtimeve të vogla dhe duke e mirëmbajtur Autoudhën dhe rrugën N9 në kushtet e nevojshme dhe të realizoj mirëmbajtje të pa planifikuar të shkaktuar nga ngjarjet e jashtëzakonshme, sikur që janë aksidentet, fatkeqësitë natyrore, kushtet e jashtëzakonshme të motit dhe të ngjashme.

Kontraktuesi për mirëmbajtje do të sigurojë që testimi i të gjitha materialeve të dorëzuara ose të ndërtuara të kryhet rregullisht nga ana e stafit të vet në teren sipas normave standarde dhe që rezultatet e këtyre testeve të shënohen në mënyrë të hollësishme dhe t'i vihen në dispozicion punëdhënësit sipas kërkesës së këtij të fundit.

Kontraktuesi për mirëmbajtje do të sigurojë masat për përdorimin e laboratorit për kontrollim të cilësisë, karakteristik për punën. Laboratori për kontrollimin e cilësisë do t'i vihet në dispozicion edhe punëdhënësit për kryerjen e testeve të tij.

kontraktuesi për mirëmbajtje duhet t'i caktojë procedurat për shënime dhe dokumentacion. Rezultatet e tërë inspektimeve do të regjistrohen. Rezultatet e testeve që përmbajnë dëshmi dokumentuese të aktiviteteve dhe shënime relevante për cilësinë e punës dhe performancës së kontraktuesit do të regjistrohen gjithashtu. Ditari i ndërtimit që plotësohet nga inxhinieri i kontraktuesit do të shërbejë si forma themelore e dokumentimit. Aktivitetet që duhen shënuar në ditarin ndërtimor (ditar) janë:

Përshkrimi i aktiviteteve ditore, numri dhe kategoria e ekipit punues, pajisjet e punës, moti dhe temperatura, etj.

Kontraktuesi për mirëmbajtje do t'i merr masat për dorëzimin e këtyre raporteve ditore tek , përfaqësuesi (menaxheri i projektit) i klientit në baza ditore.

Kontraktuesi duhet të mbajë : Librin e ndërtimit (Libri i sasive), për të dëshmuar sasitë e realizuara të mirëmbajtjes .

Ditari i ndërtimit dhe Libri i ndërtimit do të mbahet nga kontraktuesi dhe verifikohet dhe nënshkruhet nga , personi i autorizuar i kontraktuesit dhe Menaxherit të projektit (Mbikëqyrësit).

4.2 Punët Përgatitore (obligimet e kontraktuesi)

caktoj planet dhe programet vjetore për kryerjen e aktiviteteve për mirëmbajtje , duke e përfshirë planin për sigurim të cilësisë dhe masat praktike për t'iu shmangur, korrigjuar ose lehtësuar ndikimet shoqërore dhe mjedisore të aktiviteteve të tyre .

mobilizojë burimet e duhura (personelin, pajisjet, materialet, etj.) për t'i realizuar tërë aktivitetet e kontraktuara të mirëmbajtjes (rutinë dhe mirëmbajtjes dimrore) .

në vazhdimësi gjatë tërë afatit të kontratës të ndihmoj punëdhënësin në menaxhimin e rrjetit të Autoudhës dhe rrugës N9, duke e mbajtur kadastrën e rrjetit të Autoudhës dhe rruges N9 , duke e azhurnuar arkivin e dokumenteve, duke i siguruar raportet mbi rezultatet e inspektimit dhe të gjitha shërbimet e realizuara të mirëmbajtjes .

sigurojë burimet përkatëse (njerëzore dhe mekanizmin e përkatës) për t'iu përgjigjur rasteve të jashtëzakonshme (aksidenteve , reshjeve të mëdha dhe erodimeve të mëdha) që mund të ndodhin.

koordinojë tërë artikujt që mund të mbulohen në kuadër të periudhës së garancisë së defekteve nga ana e kontraktuesve të ndërtimit.

të siguroj lokacionin dhe ndërtoj kantierin te tij me zyrat, repartet, magazinat, etj.

Me përfundimin e Punimeve, Kontratori duhet zhvendosë të gjitha zyrat e tij, repartet, magazinat, kampin, etj dhe të pastroj lokacionin e ta kthejë ne gjendjen fillestare sipas udhëzimeve të Menxherit te Projektit dhe Planit te Menaxhimit te Mjedisit.

Kontraktuesi duhet gjithashtu të përcaktojë zonat e tij për grumbullimin dhe depozitimin e mbeturinave dhe materialeve qe nuk i nevojiten më, sipas procedurave lokale për transport dhe zhvendosje të mbeturinave.

Kontratori do përgatitë, për çdo muaj "Programin mujor te punimeve " bazuar ne inspektimin e te gjithë rrugës. Inspektimi i kontraktorit behet për të identifikuar ku është e nevojshme të nderhyet për pastrim, riparim, zëvendësim në përputhje me "nivele e kërkuar" .

Programi mujor i punëve i përgatitur do ti dorezohet Manaxherit te Projektit, ose perfaqesuesve të tij, për aprovim te pakten 7 (shtate) dite para fundit te muajit. Manaxheri i Projektit, beje aprovimin e planit mujor të punëve ose ne mirekuptim me kontraktorin do te beje modifikimin e tij para fundit te muajit.

4.3 Inspektimi dhe kontrolli

Kërkohen që të bëhen këto inspektime : Të rregullta në baza ditore , emergjente dhe sezonale

Inspektimi i rregullt i trasesë kryhet në baza ditore nga ekipet patrulluese.

Me Inspekimet e rregullta , të rrugës , strukturave rrugore , sinjalistikës dhe pajisjes së rrugës , përcaktohet nevoja e punëve urgjente , në disa elemente të rrugës dhe struktura. Kontrollimet e rregullta kryhen për çdo ditë .Inspektimet e rregullta kryehen kryesisht vizualisht dhe me matje : Vizualisht përcaktohet gjendja dhe shkalla e dëmtimeve në bankina , kanalet e hapura , rigolla , kanaleta , sistemi I dranazhimit , pusetat gjendja e pjerrësive të skarpateve , sinjalistikës , lëshesave , mureve mbrojtëse , gardhit të Autoudhës dhe N9 etj. Me matje përcaktohen pjesët e dëmtuara të pjerrësive të skarpateve , deformimet dhe dëmtimet në muret mbrojtëse dhe struktura etj.

Gjatë periudhës së erozionit dhe të periudhave me të reshura të mëdha, apo në raste tjera kur stabiliteti i rrugës dhe siguria në trafik janë të kërcënuara, inspektimet duhet të intensifikohen, në përputhje me nivelin e vlerësuar të rrezikut trasesë apo trotuarit.

4.3.1 Inspektimi sezonal

Inspektimet sezonale – Duhet të bëhe sëpaku dy here në vit , në Pranëverë dhe para fillimit të sezonës dimërore (Nëntor) . Qëllimi I inspektimeve sezonale është : të inçizoj gjendjen e rrugës , strukturave , objekteve për largimin e ujërave , sinjalistikës dhe pajisjes së rrugës .

Me inspektimet sezonale , përcaktohet :

Gjendja e shtresës qarkulluese në të gjitha sipërfaqet , rrugët kyqëse , parkingjeve etj.

Gjendja e objekteve , për largimin e ujërave atmosferik dhe nëntokësor ,

Gjendja e bankinave , shiriti ndarës , pjerrësive (gërmimit dhe mbushjes) , brezit rrugor,

Gjendja e trupit të rrugës , parçitja e erodimeve , deformet eventuale të konstruksionit dhe trupit të rrugës,

Gjendja e sinjalistikës dhe pajisjes së rrugës ,

4.3.2 Inspektimi i strukturave

Gjendja e objekteve (urave , viadukteve , mbikalimeve , nënkalimeve , mureve mbajtëse .Për gjendjen e konstatuar duhet të hartohet procesverbali me përshkrime detale) .

Ky inspektim përcakton gjendjen e strukturës dhe nivelin e dëmit.

Gjendja e strukturës përcaktohet përmes inspektimit të drejtpërdrejtë dhe me përdorimin e pajisjes gjegjëse për inspektim, në bazë të nevojës.

Ky tip i inspektimit kryhet nga ana e stafit të kualifikuar, zakonisht pas periudhës së dimrit por gjithashtu edhe në vjeshtë, nëse tregohet nevoja. Është i obliguar përpilimi i një raporti të shkruar.

Për gjendjen e konstatuar të strukturave duhet të hartohet procesverbali me përshkrime detale I cili nënshkruhet nga personi i autorizuar i kontraktuesit dhe Menaxheri i Projektit (Mbikëqyrësi) .

tij, nuk është kryer me profesionalizem dhe duhet ribërë.

Ndalja e herëpashershme është e nevojshme gjatë inspektimit, për fotografim, matjen e rrafshësisë së asfaltit, gjerësinë dhe thellësinë e të qarave (përcaktimi i intensitetit të dëmeve).

4.3.3 Inspektimi emergjent

Inspektimi emergjent i trasesës bëhet :

Pas ngjarjeve të jashtë zakonshme (aksidenteve të komunikacionit ,fatkeqësitë natyrore, eksplozimet, rrëshqitjes së dheut , deformimit të trupit të rrugës etj.)

Para, kalimit të transporteve të jashtëzakonshme

Dëmtimeve të strukturave etj.

Inspektimet emergjente kryhen nga ana e stafit të ekspertëve, të punësuar nga ana e kompanisë për mirëmbajtjen e rrugës , Menaxherit të projektit , nëse është e nevojshme nga stafi profesional i Klientit dhe në raste të veçanta mund të angazhohen edhe ekspertë të jashtëm të punësuar nga ana e organizatave apo institucioneve të specializuara. Rezultati i një inspektimi të tillë është raporti i shkruar dhe vlerësimi lidhur me gjendjen e rrugës , pas aksidentit me propozimin e masave për sanimin e gjendjes .

4.4.Mbrojtja e Mjedisit

Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për kryerjen e punimeve ashtu që mos të ketë ndikime negative në mjedis

Kontraktuesi do të minimizojë efektet e zhurmës, dridhjeve dhe pluhurit që rezultojnë nga kryerja e punëve, veçanërisht në punishtet në vendet e banuar;

Kontraktuesi do të heqë të gjitha mbeturinat nga punishtja dhe të gjitha materialet bituminoze do të largohen në një deponi të përcaktuar nga Projekt Menaxheri. Në anën tjetër Projekt Menaxheri do të jetë përgjegjës për përcjelljen e punëve në riciklimin pasues ose heqjen e këtyre materialeve bituminoze në përputhje të plotë me rregullat e mbrojtjes së mjedisit .

Kontraktuesi do të minimizojë dëmtimet ndaj mbushjeve, konstruksionit të rrugës, pemëve dhe gjelbërimit përreth punishtes dhe do të jetë përgjegjës për rikthimin e punishtes në nivelin e kushteve përpara fillimit të punës.

Gjatë përgatitjes së gropave për mbushje me material bituminoz, Kontraktuesi duhet të ndërmarr vetëm disa punë të mjaftueshme paraprake në baza ditore në mënyrë që të garanton se gropat e tilla të përgatitura të mbushen gjatë të njëjtës dite dhe mos të lihen të pambushura.

Gërmimet e kanaleve, formimi dhe pastrimi i bankinave duhet bërë në një mënyrë të tillë që të ruajë të gjithë përbërësit e sinjaleve të trafikut në mënyrë që ato të funksionojnë gjatë punës. Në qoftë se gjatë gërmimit nuk është e mundur të mbahen sinjalet e trafikut në vend, çmontimi i tyre duhet të bëhet me aprovimin e Projekt Menaxherit, i cili do të përcaktojë vendin e magazinimit. Punët nuk përfshijnë heqjen e lidhjeve të cilat janë në shfrytëzim, si: kablllo elektrike, linja telefonike, instalime për furnizimin e ujit. Të gjitha gërmimet duhet të bëhen në përputhje me këndin e përshkuar nga Projekt Menaxheri, duke marrë parasysh vetitë e kërkuara për përdorimin e propozuar të materialit të gërmuar, të gjitha në përputhje me përshkrimet teknike.

Kontraktuesi duhet t'i mbulojë kamionet gjatë transportimit të materialeve.

Kontraktori, gjatë përdorimit të një baze të licencuar të asfalti, duhet të paraqesë tek Menaxheri i Projektit masat e planifikuara për shmangien e zhurmës dhe ndotjes së mjedisit në atë zonë.

Niveli i zhurmave gjatë një dite pune kur punohet në zona urbane nuk duhet të jete me i larte se 70dBLaeq (dyfish i zhurmës mesatare) matur në një pikë në murin më të afërt të ndërtesës më të afërt të Objektit.

Nuk do të përdoren materiale apo produkte, cilësia e të cilave nuk është certifikuar me certifikatë cilësie .

Kontraktuesi do të jetë plotësisht përgjegjës për garantimin e cilësisë për të gjitha materialet dhe punimeve në përputhje me Specifikimet teknike , kushteve teknike dhe kërkesës së Menaxherit të Projektit.

Kontraktuesi duhet të kryejë inspektimin e vet të materialeve dhe punimeve për të qenë i sigurt që ato janë sipas Specifikimeve teknike ,para se t'ia paraqesë Menaxherit të Projektit për miratim .

Kontraktuesi duhet të kryejë testimin e materialeve dhe punëve për të qenë i sigurt që ato janë sipas Specifikimeve të parapara , para se t'ia paraqesë Menaxherit të Projektit për miratim apo pagesë.

Nuk do të ketë pagesë të veçante për Kontraktuesin , për punën e tij lidhur me testimin e materialve dhe cilësisë së punimeve .

4.5 Menaxhimi dhe kontrolli i trafikut

Menaxhimi dhe kontrolli i trafikut është i domosdoshëm për të siguruar rrjedhën e sigurt të trafikut dhe sigurimin e të gjitha informatave të nevojshme për të siguruar mirëmbajtjen e rrugës, si dhe sigurimin e të gjitha informatave relevante të gjithë përdoruesve të Autostradës dhe rrugës N9..

Sistemi grumbullon dhe procedon të gjitha informatat që kanë të bëjnë me trafikun dhe jep zgjidhje lidhur me situatat jashtëzakonshme të trafikut, të shkaktuara me kushtet e motit, punët në rrugë ose kur të shfaqet një ndërprerje në zhvillimin normal të trafikut.

Menaxhimi dhe kontrolli i trafikut si dhe koordinimi me ekipet e emergjencës, shërbimin e tërheqjes, ekipet zjarrfikëse, kryhet nga Qendra e Kontrollit dhe e Mirëmbajtjes.

Stafi i Qendrës së Kontrollit dhe të Mirëmbajtjes mbajnë Ditarin e Detyrës dhe Ditarin e Punës.

Qendra e Kontrollit dhe Mirëmbajtjes duhet të vendoset nga kontraktuesi në lokacion të përshtatshëm , për ti përmbushur kërkesat e mirëmbajtjes ,sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike dhe kushtet e kontratës.

Fusha e veprimit e të gjitha ekipeve zjarrfikëse dhe të patrullave operacionale të vëzhgimit zjarrfikës është paraprakisht e definuar, dhe ka të bëjë me fushën e përgjegjësisë të punëtorëve të mirëmbajtjes/kontraktuesve të mirëmbajtjes.

4.6. Koordinimi me Ekipet Zjarrfikëse

Në bazë të studimit dhe të "Vlerësimit të Rrezikshmërisë nga Zjarri dhe Eksplozimi teknologjik", Qendra e Kontrollit dhe e Mirëmbajtjes koordinon aktivitetet me ekipet zjarrfikëse të Komunave përgjatë koridorit të Autostradës dhe rrugës N9..

Në përgjithësi, aktivitetet zjarrfikëse përfshijnë edhe implementimin e masave parandaluese të zjarrit dhe eksplodimit, masat e fikjes së zjarrit dhe të shpëtimit të personave dhe të mirave të kërcënuara nga zjarri dhe eksplozioni, dhënia e ndihmesës teknike gjatë aksidenteve dhe në situata me kërcënim potencial, si dhe kryerja e detyrave tjera në situatat emergjente, ekologjike dhe aksidenteve tjera.

Plani i mbrojtjes nga zjarri për disa seksione dhe struktura të Autostradës definojnë detyrat dhe fushëveprimin e aktiviteteve të të gjitha ekipeve zjarrfikëse si dhe patrullat operacionale të vëzhgimit zjarrfikës, detyrat e lidhura me procedurën gjatë evakuimeve, shpëtimit dhe të vet procedurave të intervenimit.

4.7 INSPEKTIMET DHE PROVAT (Detyrat e kontraktuesit dhe Menaxherit të Projektit)

Kontraktuesi do të kryejë inspektime të nivelit të shërbimit në rrjetin e rrugëve që përfshijnë të gjitha aspektet që mund të vlerësohen me metoda të thjeshta, si inspektimet pamore dhe matjet e thjeshta që nuk kërkojnë pajisje komplekse. Çdo inspektim do të dokumentohet me një raport që përfshinë informacionin e detajuar .

Manexheri i projektit mund të kryejë inspektime me nismën e vet, në çdo kohë dhe në çfarëdo seksioni të rrugës që përfshihet në Kontratë. Manexheri i Projektit do përdorë burimet e tij për ato inspektime. Nëse ai dallon çfarëdo seksioni ku nivelet e cilësisë së shërbimit nuk janë arritur, ai do të informojë Kontraktorin brenda 24 orëve me shkrim, me qëllim që Kontraktuesi të marrë veprime për eliminimin e të metave në një afat sa më të shkurtër.

Kontraktuesi do vendosë, brenda strukturese së tij organizative, një Njesi Vete-Kontrolli të veçantë të plotësuar me personel të kualifikuar, detyra e të cilit është të monitorojë dhe mbështesë verifikimin e shkalles së perputhjes me nivelet e Cilësisë së Shërbimit. Njësia e Vetë-Kontrollit gjithashtu do kryejë ose organizojë prova dhe matje; përgatitë dhe dorezoje tek Manexheri i Projektit gjithë informacionin me qëllim të krijimit të dokumentacionit të përcaktuar në Specifikimet teknike për manexhimin dhe mirëmbajtjen efektive të rrugëve. Njësia e vetë-kontrollit do kryejë gjithashtu ose monitorojë, në bashkëpunim të ngushtë me Manexherin e Projektit, verifikimet mbi Nivelet e Cilësisë së Shërbimit.

4.7.1 VERIFIKIMET

Niveli i arritur i cilësisë së shërbimit do verifikohet përmes Inspektimit të Përbashkët nga Manexheri i Projektit dhe Kontraktuesi. Inspektimi i Përbashkët do të kryhet një herë në muaj dhe do jetë bazë për vërtetimin nga Manexheri i Projektit të raporteve mujore, pra inspektimet përbëjnë vlerësimin e punimeve të kryera.

Inspektimet e Përbashkëta do kryhen në të gjithë segmentin rrugor. Çdo Inspektim i Përbashkët do dokumentohet nga një Raport Mujor Verifikues i Përbashkët.

Inspektimet e përbashkëta programohen që përpara nga Manexheri i Projektit dhe kryhen nga Kontraktuesipërmes Njesisë së tij të Vetë-Kontrollit. Qëllimi kryesor i inspektimit formal është që të verifikojë informacionin mbi cilësinë dhe sasinë e punimeve të realizuara dhe nivelin i Cilësisë së Shërbimit të arritur nga Kontraktuesi dhe të mbyllur në pasqyrën mujore për vërtetim nga Manexheri i Projektit.

Manexheri i Projektit duhet të informojë Kontraktorin për qëllimin e tij për të kryer një Inspektim të Përbashkët. Ai duhet të ep njoftim të paktën 24 orë para, duke treguar datën e saktë, orën dhe vendin ku do fillojë Inspektimi i Përbashkët. Kontraktuesi është i detyruar të jetë i pranishëm në atë datë, orë dhe vend që thote Manexheri i Projektit, duke siguruar mjete fizike të nevojshme për inspektim. Inspektimet e Përbashkëta programohen normalisht, por jo domosdoshmerisht të fillojnë brenda me pak se 2 (dy) dite mbas paraqitjes nga Kontraktuesi të paqyres mujore Manexherit të Projektit; dhe ata duhet normalisht të kryhen brenda një maksimumi prej 5 (pese) ditësh.

Inspektimet e Përbashkëta lejojnë krahasim të informacionit të dhënë nga Kontraktuesi në inspektimet e specifikuar dhe provat si edhe në sistemin e tij të vete-kontrollit me matje aktuale nga Manexheri i Projektit.

Inspektimet e Përbashkëta do përfshijnë gjithashtu edhe vizita kontrolli në terren të seksioneve, për të cilat janë verifikuar defektet dhe brenda kufijve kohore të caktuara nga Manexheri i Projektit dhe të specifikuar Raportin e Përbashkët Mujor Verifikues.

Qëllimi i këtij inspektimi është që të kontrollojë nëse Kontraktuesi i ka eliminuar shkaqet e mos-pajtimeve të mëparshme, brenda afatit të përcaktuar nga Manexheri i Projektit. Për rrjedhojë këto inspektime kontrolli të përbashkëta do të kryhen veçmas, menjëherë pas skadimit të kufijve kohore të vena. Nga ana formale këto inspektime të përbashkëta mundet vetëm të perdoren për kontrollin e shënimeve të mëparshme.

Inspektimet e përbashkëta do kryhen nga Njësia e Vete-Kontrollit të Kontraktorit në bashkëpunim me Manexherin e Projektit. Mjetet matëse dhe stabilitete të ndryshme që nevojiten për inspektimin do sigurohen nga Kontraktori.

4.8 MATJET DHE PAGESAT

4.8.1 Pranimi i përkohshëm

Projekt Menaxheri së bashku me Kontraktuesin do të bëjnë vizita javore në punishte, gjatë të cilave do të përcaktojnë punët që do të kryhen në secilin seksion rrugor, duke pas parasysh natyrën e tyre. Projekt Menaxheri do të specifikojë Kontraktorit pozicionet dhe sasinë e punëve që duhen kryer. Vëmendje e veçantë duhet kushtuar shënimit me ngjyrë dhe punimit të skicave sipas formës dhe sipërfaqes së gropave në shtresat qarkulluese , me qëllim që gjatë pranimit të punëve dhe llogaritjes së pagesave, të mos ketë mosmarrëveshje në mes të Menaxherit të projektit dhe kryesit të punimeve.

Kontraktuesi është përgjegjës për çdo lloj humbjeje apo dëmtimi që mund të ndodhë në punishte , gjatë kryerjes së punimeve. Si rrjedhim, Kontraktuesi do të mbulojë kostot e këtyre humbjeve apo dëmtimeve. Në asnjë rast Punëdhënësi nuk mban përgjegjësi për humbje apo dëmtime të tilla.

Në të gjitha rastet punimet e propozuara nga kontraktuesi duhet të aprovohen nga Menaxheri i projektit . Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për zhvillimin e punimeve duke mos dëmtuar rrugën , instalimet e ndryshme në rrugë dhe pronat që kufizohen me rrugë. Në fund të çdo muaji, Projekt Menaxheri së bashku me Kontraktuesin do të përcaktojnë vëllimin e punës së kryer gjatë muajit, cilësia e së cilës duhet të përputhet me cilësinë e përshkruar me Kushtet Teknike dhe këto specifikime teknike . Menaxheri i projektit do të lëshojë një Certifikatë të pranimit të punës, ose një deklaratë që tregon se punët nuk janë të pranueshme, me komentet e tij/saj dhe arsyet për refuzim të shprehura qartë, dhe do të informojë kontraktuesin , për këtë duke i dërguar një kopje të deklaratës.

Pagesa mujore (të përkoshme) do të kryhet në bazë të sasisë së punës e pranuar nga Projekt Menaxheri, të evidentuara në Librin e Ndërtimit .

4.8.2Pranimi Final

Kontraktuesi do të informoj Menaxherine Projektit për datën kur pritet të përfundojnë të gjitha punimet jo më vonë se 7 ditë pune përpara asaj date. Menaxheri i Projektit do të caktojë me kontraktuesin datën kur do të bëhet procedura e pranimit.

II . A. PËRSHKRIMI I POZICIONEVE – MIRËMBAJTJA RUTINORE

Mobilizimi i kontraktuesit (përgatitja e stafit , mekanizimit , bazave për mirëmbajtje etj) .

Ky pozicion përfshinë formimin e kantierit , për Mirëmbajtje , mekanizimin e nevojshëm për mirëmbajtje , zyreve për staf dhe puntorë , depot për material të Mirëmbajtjes , zyrën për Mbikëqyrësin etj . Ky pozicion nuk paguhet veçmas dhe konsiderohet se është i mbuluar me çmime njësi të pozicioneve të Mirëmbajtjes .

Menaxhimi i mirëmbajtjes së autostradës dhe rrugës N9, matjet gjeodezike , librave të ndërtimit, sigurimi i kualitetit dhe mbajtja e databazës së auto udhës , në baza mujore . Ky pozicion nuk paguhet veçmas dhe konsiderohet se është i mbuluar me çmime njësi të pozicioneve të Mirëmbajtjes .

1.MONITORIMI DHE INSPEKTIMI I AUTO UDHËS DHE RRUGËS NACIONALE N9

1.1 Inspektimet ditore të rregullta të auto udhës, duke përfshirë edhe strukturat dhe objektet për largimin e ujërave

Pozicioni përfshinë : Inspekimet e rregullta , të rrugës , strukturave rrugore , sinjalistikës dhe pajisjes së rrugës përcaktohet nevoja e punëve urgjente , në disa elemente të rrugës dhe struktura. Inspektimet e rregullta kryehen kryesisht vizualisht dhe me matje : Vizualisht përcaktohet gjendja dhe shkalla e dëmtimeve në shtresa qarkulluese , bankina , kanalet e hapura , rigola , kanaleta , sistemi i dranazhimit , pusetat gjendja e pjerrësive të skarpateve , sinjalistikës , lëshesave , mureve mbrojtëse , gardhit të Autoudhës dhe rrugës N9 etj. Inspektimi bëhet në baza ditore me kamionet , ku janë të përfshirë : tekniku dhe 2 punëtorë me material dhe mekanizim , për intervenime të vogla (emergjente) . Gjatë inspektimit , kryhen edhe disa punime të shkallës së ultë , siq

janë : rregullimi dhe pastrimi sinjalistikën , largon materialet e erodura (sasi të vogla) , ndonjë papastërti ose mbeturinë e cila ka rënë , pastron grilat e ujëmbledhësave etj. Informon bazën për ndonjë ngjarje të jashtëzakonshme (aksident , erodim më të madh , dëmtim të pajisjes së rrugës) , Vendosë shenja të përkohshme , për shënimin e vendit të aksidentuar ose pjesën e rrezikuar të rrugës . Pagesa për këtë pozicion bëhet në baza Mujore .

1.2 Inspektimi sezonal i autoudhës me të gjitha objektet përcjellës (dy herë në vit)

Inspektimet sezonale – Duhet të bëhe sëpaku dy here në vit , në Pranëverë dhe para fillimit të sezonës dimërore (Nëntor) . Qëllimi i inspektimeve sezonale është : të inçizoj gjendjen e rrugës , strukturave , objekteve për largimin e ujërave , sinjalistikës dhe pajisjes së rrugës .

Pagesa për këtë pozicion , bëhet në formë paushalle dy here në vit , pas dorëzimit të Raporti detal për inspektimin dhe të gjeturat.

2. Automjeti transportues me vinç , për largimin e automjeteve të aksidentuara,

(Pozicioni Përfshinë : inspektimin e vendit , komplet me stafin percjelles, rregullimi i komunikacionit me sinjalizim , largimi i automjetit nga shiritat qarkullues , pastrimi i vendit të aksidentuar).

Pozicioni Përfshinë : Udhëtimi deri te vendin i aksidentuar , vendosja e sinjalizimit për informimin e pjesëmarrësve dhe sigurimin e vendit të aksidentuar , largimi i automjetit të aksidentuar nga shiritat qarkullues , pastrimi i vendit të aksidentuar , eventualisht edhe ndërmarrja e masave kundër zjarrit kur automjeti është kapluar nga zjarri. Kthimi në bazën për mirëmbajtje .Për pagesë duhet të kompletohen dëshmitë : Raporti për aksidentin , koha e arrijtes , puna e kryer dhe foto dokumentacioni (Raport i detajuar për çdo rast). Pagesa për këtë pozicion bëhet për orë .

3.MIRËMBAJTJA E TRUPIT TË RRUGËS

3.1 Pastrimi i shiritit ndarës , bankinave , bermës , shiritave qarkullues në rrugë dhe struktura nga mbeturinat e ndryshme , largimi kafshëve dhe qenëve të aksidentuar (baza ditore)

Ky pozicion përfshinë : pastrimin e shtresave qarkulluese në rrugë dhe struktura , bankinave , bermës , pjerrësive të skarpateve nga mbeturinat dhe erodimet e vogla . Gjithashtu duhet të largohen e kafshët ose qentë e aksidentuar. Mbeturinat duhet të ngarkohen në kamion dhe të transportohen në deponi . Pagesa për këtë pozicion bëhet për muaj .

3.2 Prerja e barit dhe shkurreve nga shiriti ndarës dhe bankinat (tri herë në vit)

Ky pozicion përfshinë : prejen e barit me mekanizim kosë mekanike të vendosur në traktor , dhe pjesërisht kositjen e barit me kositëse mekanike dore ose kosë , në pjesët ku mjetet motorike nuk mund të kenë qasje . Llogaritja dhe pagesa bëhet për km. Bari i kositur duhet të transportohet jashtë profilin të rrugës në deponi.Gjatë transportit kontraktuesi duhet të ketë kujdesë që bari mos të bjerë në rrugë dhe të shkaktoj ndonjë aksident. Pagesa bëhet për Km.

3.3 Riparimet e vogëla të shiritit ndarës

Ky pozicion përfshinë : Riparimin e gropave dhe valëzimeve në shiritin ndarës , rreth pahisë elastike , shenjave të trafikut , dhe paisjeve të ngjashme në shiritin ndarës . Riparimet bëhen duke vendos material dheu shtesë dhe shtesë humusi me trashësi t= 15cm . Pas planifikimit të materialit dhe humusit duhet të mbjellet bari . Pagesa bëhet për m2 të shiritit ndarës të riparuar.

3.4 Riparimi bankinave të dëmtuara

Pozicioni përfshinë : Grryerjen e bankinës me grejder dhe rregullimin e disniveleve të bankinës me ndihmën e dy punëtorëve të cilët do bëjnë riparimet e bankinës në vende rreth pahisë elastike , shenjave të komunikacionit , me largimin e materialit të tepërt duke formuar pjerrësin tërthore të bankinës prej : 4 -7% Në riparimin e bankinave përfshihet edhe prurja dhe transporti materialit për riparimin e bankinave , shtrirja e materialit , planifikimi dhe cilindrimi . Te Autoudha përfshihet edhe humusimi pjesëve të dëmuara të bankinës dhe mbjellja e barit . Pas riparimit niveli dhe forma e bankinës duhet të ketë formën dhe gjerësinë projektuar .Pagesa bëhet për m2 të bankinës së riparuar.

3.5 Prerja e barit dhe vegjetacionit nga: Pjerrësit e skarpateve (mbushjeve dhe gërmimeve) – tri herë në vit (përfshinë të dy anët e Auto udhës ,rrugës N9 , rrugëve kyqëse dhe rrugët e nënkalimeve .

Ky pozicion përfshinë : prejen e barit me mekanizim kosë mekanike të vendosur në traktor , dhe pjesërisht kositjen e barit me kositëse mekanike dore ose kosë , në pjesët ku mjetet motorike nuk mund të kenë qasje . Llogaritja dhe pagesa bëhet për kilometër të Auto udhës ,pa marrë parasysh gjërësinë e pjerrësive të skarpateve ose të gërmimit (prerjes) . Bari i kositur duhet të transportohet jashtë profilin të rrugës në deponi.

3.6 Prerja dhe largimi i shkurreve - (Dy herë në vit)

Ky pozicion përfshinë këto aktivitete : prerjen, shkuljen e shkurreve, pemeve, dhe degëve nga bankinat, shiriti ndarës , pjerrësitë e prerjeve, mbushjeve , përreth shenjave rrugore, shenjave të drejtimit , pahive elastike dhe pajisjeve të ngjashme brenda zonës së rrugës; duke i prerë , mbledhur, ngarkuar, dhe transportuar materialin, jashtë Zonës së rrugës (deponi).Pagesa bëhet për m2 të punës së kryer.

3.7 Largimi i materialit të eroduar nga profili i autoudhës dhe rrugëve kyqëse

Largimi i materialit të eroduar dhe materialeve prej rrëshqitjeve të dheut siç janë degët e drunjtëve, dheut dhe gurëve , duhet me qenë punë e prioritetit të lartë ,para se të kryhen punët tjera me qëllim që të mënjanohen rreziqet në komunikacion ose aksidentet e mundshme.

Ky pozicion përfshinë : Vendosjen e shenjave për sigurimin e komunikacionit të sigurt të trafikut, heqjen e gurishteve, gurëve të rënë dhe dherave të rënë në rrugë . Kontraktuesi duhet të vendosë sinjalizimin përkatës për informimin e pjesëmarrësve në komunikacion dhe sa ma shpejt ta mobilizoj fuqinë punëtore dhe pajisjet për largimin e materialeve të cilat mandej duhen të ngarkohen, transportohen dhe deponohen sipas udhëzimeve të Projekt Menaxherit. Pas largimit të materialit të këtitillë sipërfaqja e rrugës dhe skajet e shtresës qarkulluese , bankina , berma ose rigola duhet të pastrohen .

Kerkesat :Pjesa e rruges ku kane ndodhur rreshqitjet do shenohet jo me vone se 2 ore mbas marrjes se informacionit mbi ngjarjen. Gjatë largimit të materialit, profili rrugor nuk duhet të dëmtohet . Gjithashtu nuk lejohet , dëmtimi i pajisjeve të (pahitë elastike , shenjat rrugore etj.) rruges, përndryshe kontraktuesi do ngarkohet me riparimin e tyre.Pagesa bëhet për m3 të materialit të larguar dhe transportuar në deponi jashtë profilin të Auto udhës rrugës N9..

3.8 Planifikimi dhe riparimi i pjerrësive të skarpateve të gërmimit dhe mbushjes .

Ky pozicion Përfshinë : largimin e materialit jostabil , jashtë profilin të rrugës në deponi , sjellja e materialit për riparim të pjerrësisë, planifikimi i pjerrësisë dhe ngjeshja e materialit . Pas zëvendësimit të materialit pjerrësia e skarpates duhet të planifikohet dhe të ketë pjerrësin e projektuar , të humuzohet në trashësi t=15cm dhe të mbjellët bari .Pagesa bëhet për m2.

3.9 Humusimi dhe mbjellja e barit në shiritin ndarës , bankina dhe pjerrësitë e skarpateve

Ky pozicion përfshinë : pastrimin e vendit , furnizimin e materialit - humusit në trashësi t=15cm, shpërndarja dhe planifikimi i humusit dhe mbjellja e barit.Pagesa bëhet për m2.

3.10 Pozicioni përfshinë : Furnizimin me material guror me dimensione 30-40cm , përgatitja e bazës për vendosjen e gurëve dhe vendosja e gurëve në shtresa 0.3-0.4m. Paga bëhet për m³. duke përfshirë të gjitha pozicionet .

4. MIRËMBAJTJA E OBJEKTEVE PËR LARGIMIN E UJËRAVE

4.1 Pastrimi dhe formësimi i kanaleve të dheut (Sëpaku dy herë në vit dhe pas të reshurave të mëdha atmosferike).

Pozicioni përfshinë : Pastrimin , thellimi , profilimi i kanaleve në profilin dhe ramjen gjatësore të projektuar, ashtu që mos të pengohet rrjedha normale e ujërave , ngarkimi në kamion dhe transporti i materialeve deri në deponi . Pastrimi i kanaleve bëhet me eskavator dhe pjesërisht me dorë (fuqi punëtore në lokacionet ku makineria nuk mund të ketë qasje) . Nuk lejohet që uji të mbetet në kanal. Paga bëhet për m' të kanalit të pastruar , së paku 2 herë në vit .

4.2 Pastrimi i rigolave (së paku tre herë në vit dhe pas të reshurave të mëdha atmosferike)

Materialet dhe mbeturinat të cilat bllokojnë rigolën me bërmen dhe skajorët duhet të largohen duke i ngarkuar dhe shkarkuar ato sipas udhëzimeve të Projekt Menaxherit. Pas grumbullimit dhe largimit të mbeturinave, rigolat duhet të pastrohen . Pastrimi kryesisht duhet të bëhet me fshesë mekanike e montuar në " Unimog " . Në raste të veçanta , lejohet edhe pastrimi i rigolave me dorë (fshesa dhe mjete tjera për largimin e mbetjeve në rigolë) . Materialet nga rigolat duhet të ngarkohen në kamion dhe të transportohen në deponi . Matjet dhe paga bëhet , për m' të rigolës së pastruar (dy herë në vit dhe pas dhe pas të reshurave të mëdha atmosferike).

4.3 Pastrimi i kanalizimit atmosferik dhe drenazhës , duke përfshirë dhe pusetat dhe ujëmbledhësat (së paku tre herë në vit dhe pas reshjeve , erodimeve , aksidenteve etj .)

Pozicioni përfshinë : pastrimin e kanalizimit atmosferik me ujë me shtypje , kurse pastrimi i ujëmbledhësave pusetave nga mbetjet , bëhet me dorë . Materialet nga pusetat dhe ujëmbledhësat duhet të ngarkohen në kamion dhe transportohen në deponi . Paga bëhet për Km të kanalizimit atmosferik të pastruar.

4.4 Pastrimi i kanaleve të betoni dhe kanaletave (së paku dy herë në vit dhe pas reshjeve të mëdha)

Pastrimi kanaletave dhe kanaleve nga betoni nga materiali i dheut , gurishtave ose materiale tjera , kryesisht bëhet me fuqi punëtore . Materialet e depozituara , duhet të largohen nga kanali duke ngarkuar në automjete përkatëse dhe transportuar në deponi . Nuk lejohet që kanalet të mbyllën dhe most ë funksionojnë. Paga bëhet për m' të kanalit të pastruar (dy here në vit dhe pas reshjeve të mëdha) . Paga bëhet për m' të kanaleve dhe kanaletave të pastruara.

4.5 Pastrimi i tombinave Rrethore (Së paku tre herë në vit)

Ky pozicion përfshinë pastrimin e tombinave (lëshesave rrethore) nga në dheu , mbeturina të ndryshme , që si të tilla ndikojnë në strukturat hyrëse dhe dalëse. Me qëllim të rivendosjes së kapacitetit të plotë të tyre, pengesat dhe papastërtitë duhet të largohen manualisht (me dorë), të ngarkohen, transportohen dhe zbrazen në vendin ku e cakton Projekt Menaxheri. Si trajtim final, i përparësive dhe invertimi i strukturave të tilla duhet të shpërlahen me ujë me presion për të siguruar një sipërfaqe të rrjedhshme. Të pakten ¼ e diametrit të tubit do të jetë gjithmonë e lirë nga depozitimet duke lejuar rrjedhjen e lirë të ujit. Pas pastrimit materiali duhet të ngarkohet në kamion dhe transportohet në deponi . Ky pozicion paguhet për m' të pastruar të tombinës , pa marrë parasysh diametrin e tombinës .

4.6 Pastrimi i Tombinave kuti (si në pozicionin 4.5).

4.7 Pastrimi i Pusetave . Ky pozicion përfshinë pastrimin e pusetave , sëpaku dy here në vit , duke transportuar materialin në deponi , jashtë auto udhës. Paga bëhet për cope të pusetës së pastruar .

4.8 Punimi i rigolave të reja nga betoni me gjerësi $b=0.75m$

Pozicioni përfshinë : largimin e rigolës së dëmtuar me transport të materialit , punimi i pahisë , përgatitja dhe furnizimi me beton C30/37 , vendosjen e betonit me nivelizim dhe vibrim me vibrator, prerja e fugave në çdo 2.0m dhe largimi i pahisë .Pagesa bëhet për m' të rigolës së punuar .

4.9 Riparimi i kanaleve dhe kanaletave nga betoni

Pozicioni përfshinë : largimin e pjesëve të dëmtuara me mjete përkatëse , dhe riparimin e pjesë të dëmtuara me beton C25/30 ose llaqe speciale ,për dëmtime më të vogla (dëmtime sipërfaqore , plasaritje etj.). Pagesa bëhet për m' të kanalit ose kanaletës së riparuar .

4.10 Punimi i skajorëve të ri nga betoni me dimensione 18/24cm duke përfshirë edhe largimin e skajorëve të dëmtuar .

Pozicioni përfshinë : largimi i skajorëve të vjetër , pastrimi dhe përgatitja e bazës , furnizimi dhe vendosja e betonit C12/15 (0.15m³/m'),furnizimin dhe vendosja e skajorëve të parapërgatitur ose punuar nëvend me dimensione 18/24cm, C35/45 – M100 , nivelizimi dhe mbushja e fugave të skajorëve me llaç çimentoje . Matjet dhe pagesa bëhet për m' të skajorit të vendosur.

4.11 Punimi i kanaleve të reja nga betoni

Pozicioni përfshinë : largimin e kanaletës së dëmtuar me transport të materialit deri në deponi , punimi i pahisë , përgatitja dhe dhe furnizimi me beton C20/25 XC1 , vendosjen e betonit me nivelizim dhe vibrim me vibrator , prerjen e fugave në çdo 2.0m me mbushjen e fugave me llaç çimentoje . Sasia e betonit 0.33m³/m'. Pagesa bëhet për m' të kanalit të punuar.

4.12 Punimi i kanaletave nga betoni

Pozicioni përfshinë : largimin e kanaletës së dëmtuar me transport të materialit , punimi i pahisë , përgatitja dhe dhe furnizimi me beton C20/25 XC1 , vendosjen e betonit me nivelizim dhe dhe vibrim me vibrator dhe prerjen e fugave në çdo 2.0m me mbushjen e fugave me llaç çimentoje 0.25 m³/m'. Pagesa bëhet për m' të kanaletës punuar.

4.13 Ndrimi i grilave të ujëmbledhësave

Pozicioni përfshinë : largimin e pjesëve të dëmtuara rreth ujëmbledhësit , pastrimi i ujëmbledhësit dhe furnizimi dhe vendosja e ujëmbledhësit të ri me dimensione dhe material , sikurse ujëmbledhësi i vjetër , me aftësi bartëse 40 MN (40 tona). Pagesa bëhet për copë të ujëmbledhësit të vendosur.

4.14 Ndrimi e kapakëve të dëmtuar të pusetave

Pozicioni përfshinë : largimin e pjesëve të dëmtuara rreth Pusetës , pastrimi i pusetës furnizimi dhe vendosja e kapakut të ri të pusetës me dimensione dhe material , sikurse puseta e vjetër , me aftësi bartëse 40 MN (40 tona). Pagesa bëhet për cope të kapakut të vendosur.

4.15 Riparimi i kokave hyrëse dalese të tombinave rrethore dhe kuti.

Pozicioni përfshinë : riparimin e kokave të dëmtuara të lëshesave (tombinave) , duke larguar pjesët e dëmtuara , vendosjen e pahive dhe betonit C25/30 dhe largimin e pahisë.Pagesa bëhet për copëtë riparuar të kokave hyrëse dalese të tombinave rrethore dhe kuti.

4.16 Pastrimi dhe mirëmbajtja e baseneve , lagunave (së paku tre herë në vit)

Lagunat

Laguna duhet të kontrollohet rregullisht dhe të pastrohet , së paku dy herë në vit. Shpatet e argjinaturave duhet të kositen sëpaku dy herë në vit, për të parandaluar zhvillimin e formave të tjera bimore përveç barit. Largimi i sedimenteve është i rëndësishme sepse këto zvogëlojnë vëllimin e përdorshëm të lagunës dhe si pasojë zvogëlon efikasitetin e saj.

Bazene sedimentimi

Bazenet e sedimentimit duhet të kontrollohet dy herë në vit. Bari duhet të kositet se paku dy herë në vit, trashësia e sedimenteve duhet të kontrollohet, të pastrohen dhe të hiqen mbeturinat e mundshme në hyrje dhe tubat e shkarkimit, të sigurohet kalim i lirë si dhe të kontrollohen kushtet e përgjithshme të pjesëve përbërëse të rezervuarit të sedimenteve. Materiali nga lagunat dhe bazenet e sedimentimit , duhet të ngarkohet në kamiona dhe të transportohet në deponi . Pagesa bëhet për copë të pastruar të Lagunës dhe basenit sedimentues .Çmimi njësi përmban pastrimin e baseneve dhe Lagunave , sëpaku 3 herë në vit. Pagesa bëhet për cope të basenit sedimentues ose Lagunës.

5. MIRËMBAJTJA E SHTRESAVE T ASFALTIT

5.1 Pastrimi dhe Larja e kohëpaskohëshme e sipërfaqes qarkulluese , sipas udhëzimit të organit mbikqyrës (së paku 3 herë në vit dhe pas të reshurave të mëdha)

Pastrimi i shtresave të asfaltit duhet të realizohet me fshisë motorike e montuar në " Unimog " . Në pjesët e veçanta pastrimi bëhet me fuqi puntore (fshisa dhe mjete tjera ndihmëse). Mbeturinat duhet të ngarkohen në kamion dhe transportohen në deponi . Gjithashtu kërkohet që të bëhet edhe larja e sipërfaqes së asfaltit me automjet me spërkatje automatike të ujit . Pagesa bëhet , për km (dy here në vit) .

5.2 Riparimi i gropëzimeve, gjurmëve, plasaritjeve të shtreses qarkulluese deri në 4.5 cm trashësi. (SMA nga materiali eruptiv) .

Pozicioni përfshinë : Identifikimi dhe shënimi gropave me ngjyrë .Prerja e asfaltit me makinë prerëse duhet të jetë me sipërfaqe të rregullta gjeometrike . Fundi i gropave dhe pjesët vertikale duhet të pastrohet mirë , para spërkatjes me emulsion.Pas pastrimit bëhet spërkatja me emulsion 0.5kg/m2 e fundit dhe anëve të gropës . Kjo sipërfaqe e shtresës ngjitesë ose spërkatjes emulsive duhet të mbahet pastër dhe asfalt betoni që përdoret për mbushjen e gropave duhet të vendoset 2-3 orë më vonë.

Mbushja e gropave me asfalt beton:

Asfalt betoni duhet të transportohet me anë të kamionëve vetëshkarkues. Fundi i kamionave duhet të jetë metalik ose i mveshur me metal pa korozion, baltë, asfalt ose materiale tjera. Me qëllim të evitimit të ngjitjes së asfaltit në kamion rekomandohet spërkatja e anëve dhe fundit të kamionit me përbërje të sapun kaliumit. Nuk lejohet spërkatja me produkte të bazuara në petrolejum. Gjatë transportit përzjerja e asfaltit duhet të mbulohet me mbulesë adekuate.Vendosja e asfalt betonit në gropa duhet të bëhet në mënyrë manuale dhe duhet të jetë në përputhje më kërkesat në specifikim.Gjatë shtrirjes së asfalt betonit temperatura minimale e materialit duhet të jetë 150°C.Ngjeshja e shtresës së asfalt betonit nënkupton përdorimin e cilindrit vibrues 1,5 – 2 tonësh, e drejtuar me dorë e pastaj të vijon me cilindër statik prej 8-10 tonësh. Pagesa bëhet për m2 të gropes së sanuar.

5.3 Riparimi i gropëzimeve, gjurmëve, plasaritjeve të shtreses qarkulluese deri në - 11 cm trashësi.

Si në pozicionin (5.2) , por vendosja e dy shtresave asphalt , SMA16, t=4.5cm dhe AB16 shtresë lidhëse t=6cm.

5.4 Riparimi i dëmtimeve të mëdha deri në 17 cm trashësi.

Pozicioni përfshinë : Prerjen e shtresës së sipërme të shtresës qarkulluese ekzistuese dhe tamponit në thellësi deri në 35-40 cm. Largimin e materialit të dëmtuar deri në deponi . Pasi të jenë pastruar anët vertikale dhe fundi i pjesës së dëmtuar, fundi nivelohet dhe ngjeshët dhe mbushja e pjesës së dëmtuar bëhet si në vijim: bëhet

furnizimi dhe shtrirja e materialit bazë –gurë të thyer (0–31.5mm),përafërsisht të trashësisë prej 20 - 25 cm duke përfshirë këtu nivelimin dhe ngjeshjen. Furnizimin dhe vendosjen e shtresave të asfaltit me kompaktim (shtresë bitoagregati në trashësi 8cm , AB 16 , t= 6cm dhe SMA16, t=4.5 cm) , duke përfshirë edhe spërkatjen me emulsion 0.5kg/m2 në mes të shtresave dhe anëve të gropave . Paga bëhet për m2 të gropes së sanuar.

5.5 Shtresa e re qarkulluese SMA , 16 me trashësi mesatare prej 4.5cm me grryerje.

Pozicioni përfshinë : Largimi i shtresës së sipërme të sipërfaqes ekzistuese rrugore prej 4 cm thellësi, me makinë grryerëse " Wirtgen " –ose tip tjetër , me largimin e materialit dhe pastrimin e sipërfaqes qarkulluese ku është bërë grryerja .Pas grryerjes dhe pastrimit të sipërfaqes , vendoset emulsioni 0.3-0.5kg/m2 dhe fillohet vendosjen e shtresës së asfaltit me finisher.

Vendosja e Shtresë së asfaltit .

Shtruarja e asfalt betonit duhet të bëhet menjëherë pasi që Projekt Menaxheri e ka pranuar sipërfaqen e tillë të përgatitur. Metoda e transportimit deri në punishte duhet të bëhet në mënyrë të njëjtë siç është specifikuar për asfalt betonin që shfrytëzohet për mbushjen e gropave. Temperatura e asfalt betonit para se të bëhet shtrirja varet prej llojit të bitumenit të specifikuar. Për llojin e bitumenit BIT 50/70 i cili shfrytëzohet në Kosovë, temperatura minimale e asfalt betonit duhet të jetë 140°C. Kurse e bitoagregatit 130°C.

Me qëllim që të arrihet kualiteti i kërkuar i shtresës së asfalt betonit, materiali duhet të vendoset duke përdorur makinerinë në vijim:Finisheri;Cilindrat me rrota gome, vibruese dhe statike;Cisternat (tanket) e ujit;Spërkatës bitumeni;Prerës i asfaltit; dhe Kompresor ajri.

Asfalt betoni duhet të shtrihet përmes finisherit i cili pas shpërndarjes, pjesërisht e bën edhe ngjeshjen e masës së asfaltit . Sasia, prodhimi dhe furnizimi i asfalt betonit duhet të jetë në përputhshmëri me sasinë e cila aktualisht mund të shtrohet dhe ngjeshët. Nëse qoftë furnizimi apo shtrirja e materialit ndërpritet kjo do të shkaktojë uljen e temperaturës së materialit i cili gjendet në finisher nën temperaturën minimale, atëherë punët e mëtutjeshme suspendohen. Shtresa me asfalt përzierje duhet të kontrollohet menjëherë pas shpërndarjes në mënyrë që të vërtetohet niveli i sipërfaqes së re. Sipas nevojës disnivelet (tepricat ose mungesa) e materialit duhet të përmirësohen menjëherë pas kalimit të finisherit. Kontraktuesi duhet të kontrolloj nivelin e sipërfaqes duke formuar këndin e drejtë përmes një late me gjatësi 4 m si dhe trashësisë së shtresës pas shpërndarjes së materialit.

Duhet aplikuar tri faza të ngjeshjes së shtresës së re të asfaltit:Ngjeshja preliminare e cila bëhet me cilindër në nivel të temperaturave më të larta të përzierjes së asfaltit,Ngjeshja kryesore për të arritur ngjeshjen e barabartë të kërkuar të shtresës së asfaltit; dheNgjeshja finale për përforcimin e disniveleve të shkaktuara nga ngjeshjet e mëparshme dhe për arritjen e sipërfaqes së kënaqshme.

Për ngjeshjen preliminare cilindri duhet ta përcjellë finisherin në distancë prej 0-60 m. Distanca për ngjeshjet vijuese përcaktohen në punishte duke pas parasysh gjendjen ekzistuese gjatë punës. Paga bëhet për m2 të asfaltit me të gjitha pozicionet e cekura më lartë .

5.6 Riparimi i plasaritjeve dhe çarjeve(në çmim njësi te përfshihet hapja dhe pastrimi i plasaritjeve/çarjeve si dhe mbushja me masë bituminoze).

Formimi dhe zhvillimi i plasaritjeve në shtresën qarkulluese duhet të evitohet me qëllim të ndalimit të depërtimit të ujërave atmosferik në shtresat e konstruksionit të rrugës që mund të shkaktojnë mufatje të ngricave gjatë dimrit dhe zhvillimit të gropave më vonë.

Pozicioni përfshinë :furnizimin e masës së bitumit , rërës dhe gasit për nxemjen e masës së bitumit , dhe kompresorit për pastrimin e plasaritjeve. Gjatë punës duhet të përdoren këto makineri :kompresor për pastrim , pajisja për nxemjen dhe vendosjen e masës së bitumit për mbushjen e plasaritjeve . Pas pastrimit të plasaritjeve , bëhet mbushja e plasaritjeve me bitum të nxehtë dhe vendosja e rërës së terur mbi sipërfaqen e

bitumit Pozicioni përfshinë edhe vendosjen e sinjalistikës dhe rregullimin e komunikacionit , gjatë kryerjes së punimeve. Paga bëhet për m' të plasaritjes së sanuar .

5.7 Trajtimi me filer (ose rere) dhe bitum në sipërfaqe me tepricë bitumeni, ose të lustruar

5.8 Grryerja e asfaltit me "Wirtgen" në thellësi deri në 4.5cm

Pozicioni përfshinë : Largimi i shtresës së asfaltit në thellësi prej 4 cm thellësi me makinë grryerëse " Wirtgen " – ose ndonjë tip tjetër . Largimi i materialit të grryer me transport deri në deponi dhe pastrimi sipërfaqes qarkulluese ku është bërë grryerja. Paga bëhet për m2 të sipërfaqes së grryer .

6 MIRËMBAJTJA E STRUKTURAVE (urat,lëshesat, muret mbrojtëse , mbikalimet nënkallimet etj .)

6.1 Pastrimi trotuareve , shtigjeve të këmbësorëve , parapetëve , nënstrukturave , fugave të dilatimit , sistemit të kullimit , sipërfaqes rreth objektit struktural , sipërfaqes qarkulluese e (Dy herë në vit dhe pas të reshurave)

Pastrimi i pjesëve të strukturave përfshinë : Pastrimin e pjesëve të konstruksionit të strukturave , trotuareve,objekteve për largimin e ujërave (ujëmbledhësave) , fugave të dilatimit , mbështetësave , sipërfaqes qarkulluese , pastrimin e nënstrukturës , pastrimin e pjesëve të sipërfaqes nën urë , fugave të dilatimit , mbështetësave neopren ,heqja e materialeve të forta dhe të ndryshkut nga vidat dhe bulonat . Paga bëhet paushall – çmimi njësi përfshinë pastrimin , sèpaku dy here në vit.

6.2 Riparimi i brigjeve të prockave dhe lumejve deri në 200m

Kërkohet që te urat mbi lumej të bëhet pastrimi i rrjedhës së lumejve dhe prockave nga mbeturinat , degët dhe materialet e ndryshme , duke rregulluar shtratin e lumit . Materialet duhet të ngarkohen në kamion dhe të transportohen në deponi . Paga bëhet për m' të rrjedhës së pastruar të lumit .

6.3 Riparimi i fugave të dilatimit Kërkohet që të bëhen riparimet e vogla të mundëshme te fugat e dilatimet deri në zëvendësimin e tyre .Paga bëhet për m' të fugës së riparuar.

6.4 Zëvendësimi i fugave të dilatimit te strukturat

Pozicioni përfshinë : Largimin e fugës së dëmtuar , pastrimi i vendit , furnizimi dhe vendosjes e fugës së re duke përfshirë edhe rregullimin e komunikacionit gjatë vendosjes së fugave . Paga bëhet për m' të fugës së re të vendosur , Tipi dhe karakteristikat e njejta me tipin e vjetër të fugës së dilatimit. bëhet për m' të fugës së vendosur .

6.5 Riparimi parapetëve dhe gardhit të urave

Pozicioni përfshinë : Riparimet e veçuara të parapeteve të këmbësorëve, parapeteve të sigurisë dhe parapeteve të kombinuara ,përtëritja e axhustimeve të dëmtuara, - zëvendësimi i pjesëve metalike që mungojnë , pastrimi me brushë nga telat metalike të pjesëve të ndryshkura gjer në lustrim metalik , aplikimi i dy shtresave paraprake të ngjyrës bazë .Paga bëhet për m' të Riparimi parapetëve dhe gardhit të urave.

6.6 Ndërimi i parapetëve dhe gardhit të urave

Pozicioni përfshinë : Largimin e barrierave (parapetëve të dëmtuar me mjete përkatëse) , ngarkimi dhe transporti në deponi i materialit . Pastrimi dhe përgatija e vendit.Furnizimi dhe vendosja e barrierave dhe gardhit të urave , tipi i njejtë me barrierat e projektuara . Paga bëhet për m' të ndërrimit të parapetëve dhe gardhit të urave .

6.7 Zëvendësimi i skajorëve nga betoni

Pozicioni përfshinë : largimin e skajorëve të dëmtuar me transport të materialit në deponi Furnizimi me skajor , klasa C35/45 M100 dhe vendosja e skajorëve Zëvendësimet e veçura të skajoreve (do të përdoren skajoret e tipit të njëjtë si origjinalet. Fugat në mes të gurëve skajore do të mbushen me llaq çimentoje .Skajorët duhet të zëvendësohen menjëherë pas shfaqjes së dëmtimeve . Matjet dhe pagesa bëhet për m' të skajorit të vendosur.

6.8 Zëvendësimi i ujëmbledhësave te strukturat

Pozicioni përfshinë : largimin e ujëmbledhësit të dëmtuar me përpunimin e anëve rreth ujëmbledhësit dhe pastrimi i ujëmbledhësit , për vendosjen e ujëmbledhësit të ri . Furnizimi dhe vendosja e ujëmbledhësit të ri – tipi i njëjtë sikurse ujëmbledhësi i vjetër . Pagesa bëhet për cope të ujëmbledhësit të vendosur.

6.9 Riparimi i hidroizolimit te urat (me të gjitha operacionet paraprake) .

Aty ku vërehet se është dëmtuar izolimi në urë , duhet të ndërmerren masat për ndrrimin e izolimit . Pozicioni i ndrrimit të izolimit përfshinë : largimin e shtresave qarkulluese të asfaltit , largimine izolimit të dëmtuar , pastrimin e vendit ku është larguar izolimi , rivendosjen e izolimit me të gjitha pozicionet dhe shtresave të asfaltit , duke përfshirë vendosjen e sinjalizimit dhe barrierave mbrojtëse për informimin e pjesmarrëseve për punime dhe mbrojtjen e punëtorëve që kryejn punimet në ndrrimin e izolimit të urës. Shtresat qarkulluese dhe izolimi duhet të punohen nga materiali i njëjtë , si në pjesët tjera të strukturës . Pagesa bëhet për m2 të izolimit të vendosur.

6.10 Riparimi i dëmtimeve të asfaltit te ujëmbledhësat te urat (të gjitha operacionet)

Pozicioni përfshinë : Largimin me kujdestë pjesëve të dëmtura rreth ujëmbledhësit , pastrimi i vendit , sanimi i pjesëve të dëmtuara rreth ujëmbledhësit . Pagesa bëhet për m2 të punës së kryer.

6.11 Riparimi konuseve të urës me mveshje nga guri (kalldërm)

Pozicioni përfshinë : Përgatitjen e bazës , furnizimin me material (guri) , punimin e kalldërmës nga guri me trashësi t=25cm e vendosur në shtresë rëre , t=15cm , mbushja e fugave të kalldërmës me llaq çimentoje . Pagesa bëhet për m2 të kalldërmës së përfunduar .

6.12 Riparimet e vogëla të krahëve të urave dhe lëshesave me beton C30/37 duke përfshirë edhe armirimin

Pozicioni përfshinë : largimin e pjesëve të dëmtuara të betonit me transport të këtijë materiali deri në deponi . Pastrimi i vendit, punimi dhe montimi i pahisë , furnizimi dhe vendosja e armaturës 65kg për m3 të betonit , furnizimi dhe vendosja e betonit C25/30 dhe largimi i pahisë. Pagesa bëhet për m3 të betonit të vendosur , duke përfshirë të gjitha aktivitetet e cekura më lartë.

6.13 Punimi i mureve të reja nga betoni i armuar klasa C25/30 duke përfshirë edhe armirimin 65kg./m3 të betonit

Pozicioni përfshinë : hapjen e themeleve , transportin e dheut të gërmuar , vendosjen e tamponit t= 15cm , furnizimin me beton C16/20 për shtresën e betonit me trashësi t= 10cm , furnizimin dhe vendosjen e pahisë , gypave nga PVC □110mm , furnizimin , lakimin dhe montimin e armatures S500H , furnizimin dhe vendosja e betonit C25/30 , për themele dhe muri duke përfshirë edhe largimin e pahisë pas lidhjes së betonit . Pagesa bëhet për m3 të betonit , duke përfshirë të gjitha pozicionet e cekura.

6.14 Riparimi i mureve të gurit (gabionit)

Pozicioni përfshinë : Furnizimin me material guri për riparimet e dëmtimeve të vogëla , riparimi i rrjetave me lidhjen dhe përforcimin e tyre . materiali i gurit duhet ti plotësoj kërkesat e parashtruara në Pozicionin 6.14 . Pagesa bëhet për m3 , të gabionit të përfunduar , duke përfshirë të gjitha aktivitetet e cekura më lartë.

6.15 Punimi i mureve gabion të reja

Pozicioni përfshinë : Furnizimi me rrjetë të zinguar , Në perputhje me analizen AASHTO T66, kablli i veshur i galvanizuar duhet t'i rezistojë ekspozimit ndaj Baker-Sulfatit pa u demtuar dhe ndryshkur .Kabell që do përdoret duhet të ketë këto cilësi : peshë , sëpaku 4 kg per m2.Çeliku duhet të ketë një fortësi në tërheqje prej 4. 000 - 6 .000 kg për cm2 me një zgjatim elastik jo me pak se 10 %.Dimensionimi minimal i kabllit që do përdoret për rrjeten do të jetë:

	Diametri mm
Trupi i kabllit	3
Perimetri i kabllit	3.75
Kabëll për lidhje dhe bashkim	2.5

MBUSHJA E KOSHAVE (GABIONAVE) ME GURË:

Mbushja e koshave me gur do të bëhet me gur nga shkëmbijtë nuk konsumohen nga ujrat apo nga kushtet e keqija atmosferike.. Pjesët e shkëmbive duhet të dimensionet , duke filluar nga 10-20 cm. Koshat e mbushur duhet të kenë një densitet jo më të vogël se 1.360 t për m3. Zbrazëtite duhet të shpërndahet në mënyrë të barabartë , megjithatë copat e mëdha të shkëmbive duhet të jenë në sipërfaqen e ekspozuar të koshave. Gurët që do të përdoren për formimin e koshave të gabionave duhet të jenë të plotë, pa plasaritje, të fortë e të qëndrueshëm. Ata duhet të kenë rezistencë në shtypje mbi 500 kg/cm2 dhe të aprovohen nga mbikqyeresi i punimeve.Gurët duhet të jenë me përmasa jo më të vogla se 10 cm dhe jo me te medhenj se 20 cm ne drejtimin vertikal, jo me te vegjel se 20 cm dhe jo me te medhenje se 50 cm ne drejtimin horizontal. Gurët duhet të jenë të latuar e të puthiten mirë. Nuk lejohet përdorimi i gurëve të vegjël për mbajtjen apo pozicionimin e gurëve të gabionit. Gjithashtu nuk lejohet përdorimi i gurëve të rrumbullakët (sferike). Pagesa bëhet për m3 , të gabionit të përfunduar , duke përfshirë të gjitha aktivitetet e cekura më lartë.

6.16 Mveshja e brigjeve të lumejve me gurë të thyer (sipas formës ekzistuese)

Pozicioni Përfshinë Furnizimin me material guri , palnifikimi vendit dhe vendosja e gurëve . Gurët duhet të kenë dimensione mb 30cm , ashtu që rrjedha e ujit të mos i bartë. Gurët vendosen në brigjet e përgatitura , nivelizuara dhe profiluara . Gurë renditen në sipërfaqen e përgatitur. Nuk kërkohet që fugat të përpunohen , port ë njetat do të mbushen me material dheu ose rëre të prura nga rrjedha e lumit. Pagesa bëhet për m2 të mveshjes me gurë.

7.SINJALISTIKA DHE PAISJA E RRUGËS

Në përgjithësi :

Punët e mirëmbajtjes së sinjalistikës dhe pajisjes së rrugës përfshijnë : inspektimin e gjendjes së sinjalistikës , pastrimin vendosjen , ndërrimin dhe riparimin e sinjalistikës dhe pajisjes së rrugës dhe në vendosjen dhe largimin e sinjalistikës së përkoshme .

Punimet në mirëmbajtjen e sinjalistikës dhe pajisjes së rrugës kryhen gjatë gjithë vitit në bazë të programit dhe gjendjes së sinjalistikës së konstatuar , gjatë inspektimeve .

Mirëmbajtja e sinjalistikës dhe pajisjes së rrugës përfshinë : pastrimin , mirëmbajtjen e sinjalistikës vertikale dhe horizontale , mirëmbajtjen gardheve dhe rrjetave , ndriçimit të rrugës dhe punimet emergjente të paparashikuara .

Pastrimi : Punimet në pastrimine e baltës , pluhurit etj , kryhen sëpaku dy herë në vit dhe përfshijnë këto aktivitete : largimine të gjitha papastërtive nga shenjat , udhërrëfyesit,pahive elastike , pastaj largimin e të gjitha pengesave të cilat pengojnë dukshmërinë .

Mirëmbajtja e sinjalistikës vertikale përfshinë : riparimet e vogla në shenja vertikale , drejtimi I pjesëve të shenjave të lakuara , ndrrimin e pjesëve të dëmtuara për përforcimin e shenjave (vidat , bulonat etj) , pastrimin e vegjetacionit rreth shenjave të komunikacionit .

Punimet në mirëmbajtjen e pajisjes pahive dhe gardhimit , përfshijnë :

Inspektimin ditor , për përcaktimin e gjendjes së tyre .

Riparimin e dëmtimeve të vogla në pahitë Elastike , gardhit rrethues , gardheve për këmbësor etj

Ndrrimin e pjesëve të dëmtuara të gardhit rrethues, shtyllave të pahive elastike , përforcuesve të gardhit rrethues etj.

Plotësimin e pjesëve që mungojnë të gardhit rrethues dhe pahisë elastike .

7.1 Pastrimi i shenjave vertikale (së paku dy herë në vit)

Ky pozicion përfshinë : pastrimin e sinjalizimit vertikal (shenjave të trafikut, tabelave treguese etj .) të cilat duhet të mbahen në gjendje të pastër dhe të mirë në mënyrë që shfrytëzuesit e rrugës të mund ti dallojnë në çdo kusht atmosferik ,si gjatë ditës ashtu edhe gjatë natës.Shenjat duhet të pastrohen tërësisht duke i fërkuar me brushë dhe pastruar me ujë. Në rastin kur trajtim i tillë nuk është efektiv metodat tjera duhet të përdorën, sidoqoftë dëmtimet e ngjyrës së emajlit dhe shtresës mbrojtëse të shenjave nuk lejohet . Nëse gjatë pastrimit ka pasë dëmtime , kontraktuesi duhet që me shpenzimet e veta të riparoj dëmtimet . Gjatë pastrimit kryhen edhe disa punime të vogla siq janë : largimi vegjetacionit rreth udhërrëfyesëve , përforcimi vidave dhe bulonave , drejtimi shenjave . Pagesat për pastrimin shenjave të trafikut dhe tabelave treguese duhet të bëhet për Km, duke përfshirë pastrimin e tyre , sëpaku dy herë në vit. Çmimi njësi nënkupton pastrimin e shenjave , sëpaku dy here në vit .

7.2 Pastrimi i udhërrëfyesve (së paku dyherë në vit)

Pozicioni përfshinë : Pastrimin e udhërrëfyesve , cope për copë me brushë dhe ujë në të dy anët e e udhërrëfyesit , para dhe pas . Gjatë pastrimit kryhen edhe disa punime të vogla , siq janë : largimi vegjetacionit rreth udhërrëfyesëve, drejtimi udhërrëfyesit . Pagesa bëhet për udhërrëfyes të pastruar dhe ate dy here në vit(Çmimi njësi nënkupton pastrimin dy here në vit me çmimin njësi të ofruar) .

7.3 Pastrimi i pahisë elastike mbrojtëse të mesit (së paku dy herë në vit dhe pas aksidenteve)

Pastrimi i pahisë elastike , bëhet me ujë me shtypje nga cisterna në lokacionet e caktuara pastrimi bëhet , manualisht me fuqi punëtore , me brushë dhe ujë . Çmimi njësi nënkupton pastrimin dy here në vit të pahisë elastike me çmimin njësi të ofruar.

7.4 Pastrimi i pahisë elastike mbrojtëse anësore (sëpaku dy herë në vit dhe pas aksidenteve)

Pastrimi i pahisë elastike , bëhet me ujë me shtypje nga cisterna në lokacionet e caktuara pastrimi bëhet , manualisht me fuqi punëtore , me brushë dhe ujë . Çmimi njësi nënkupton pastrimin dy here në vit të pahisë elastike me çmimin njësi të ofruar.

7.5 Riparimi i shenja vertikale të komunikacionit

Pozicioni përfshinë : drejtimi i shtyllës dhe shenjës , përforcimi i bulonave , pastrimin , largimin e vegjetacionit dhe rregullimin e terrenit përreth shenjës . Kjo vlenë edhe për shenjat e pozicionit : 7.6 dhe 7.7

7.8 Ndrimi i udhërrëfyesve të dëmtuar

Pozicioni përfshinë : nxjerrjen e udhërrëfyesit të vjetër me ngarkim dhe transport në deponi . Furnizimi dhe vendosja e udhërrëfyesit të ri duke përfshirë edhe bazamentin nga betoni C16/20. Paga bëhet për cope të vendosjes së udhërrëfyesit të ri . 5.3 Udhërrëfyesit :Udhërrëfyesit do të bëhen me polietilen (PE) me presion të ulët ose plastike ose qelqi nga fibrat në gjatësi, me këto dimensione:Gjatësia: 120 cm,Gjërësia: 12 cm,Trashësia e murit: 0,3 cm. Thellësia e vendosjes së udhërrëfyesit në tokë është 30 cm. Pjesa fundore bëhet me përfundim prej betoni MB15, ndërsa sigurimi i pjesës së poshtme të udhërrëfyesit bëhet me anker Ø 6 mm. Pjesët e përparme dhe të pasme të shtyllave do të pajisen me reflektorë xhami, plastike, apo flete, dmth, pjesa e përparme do të pajiset me reflektor katërkëndësh, 4 cm të trashë, maks 18 cm të gjatë, ndërsa pjesa e prapme do të ketë reflektorë me diametër 2x6 cm.Distanca në mes të skajit të asfaltit dhe udhërrëfyesit do të jetë të paktën 0.50 m .

7.9 Riparimi i pahisë elastike e mesit Autoudhës (A7,A6) dhe rrugës N9.

Pozicioni përfshinë : riparimin e pjesëve të dëmtuara , përfundimin e mjeteve lidhëse (bulonave lidhëseve etj.) , drejtimin e shtyllave mbajtëse ose riparime tjera . paga bëhet për m' të pahisë elastike të riparuar.

7.10 Riparimi pahisë elastike anësore të Auto udhës

Si në pozicionin e mësipërm .

7.11 Rivendosja e katadiopterëve në pahi (sytë e macës)

Pozicioni Përfshinë : Evidentimin e katadiopterëve që mungojnë ose që janë dëmtuar , furnizimi me katadiopterë të ri dhe vendosja e tyre . Katadiopterët duhet të jenë tipi i njëjtë sikurse katadiopterët e vjetër . paga bëhet për cope të katadiopterit të ri .

7.12. Vendosja Shenjave të reja komunikacionit

Pozicioni përfshinë : demontimin e shenjës së vjetër , me sip. më të vogël se 0.5m2, ngarkimi dhe transporti i shenjës së vjetër në deponi , dhe furnizimin dhe montimin e shenjës së re duke përfshirë edhe bazamentin nga betoni sipas përshkrimit dhe detaleve të dhëna në projektin e Auto Udhës . Paga bëhet për copë të shenjës së re të vendosur .

7.13 Vendosja e tabelave të reja me sipërfaqe deri në 2.0m2

Pozicioni përfshinë : demontimin e shenjës (tabelës) së vjetër , me sip. deri në 2.0m , ngarkimi dhe transporti i shenjës së vjetër në deponi , dhe furnizimin dhe montimin e shenjës së re . Paga bëhet për copë të shenjës së re të vendosur .

7.14 Vendosja e tabelave të reja me sipërfaqe mbi 2.0m2

Si në pozicionin e mësipërm .

Sistemi i Barrierave të Sigurisë (Pahitë Elastike)

Inspektimi i të gjitha barrierave të sigurisë do të gjitha do të ndërmerret si pjesë e inspektimeve të rregullta (shërbimi patrullë), sezonale, vjetore, kryesore dhe periodike. Inspektimet do të regjistrohen dhe plotësohen me fotografi me datë. Parmakët e shkatërruar do të zëvendësohen menjëherë, jo më vonë se 48 orë pasi defekti është zbuluar, dhe në përputhje me kërkesat e prodhuesit. Parmakët e dëmtuar me funksionalitet të dëmtuar duhet të riparohen ose zëvendësohen jo më vonë se 10 ditë pasi defekti është zbuluar.

Pastrimi, larja, elemente të parmakëve do të ndërmerret çdo 3 muaj.

Pastrimi dhe larja e zëvendësimi sipas nevojës i reflektorëve do të kryhet çdo muaj.

H2 në argjinatura - referohu kërkesave të prodhuesit

H2 Mediana në rrugë - referohu kërkesave të prodhuesit

H2 urë në median - referohu kërkesave të prodhuesit

H4a mbi muret përforcues - referohu kërkesave të prodhuesit

H4b në Ura - referohu kërkesave të prodhuesit

Barrierat e lëvizshme - referohu kërkesave të prodhuesit

7.15 Pahi elastike të mesit e re – në Autoudhë

Pozicioni përfshinë : demontimin e pahisë së dëmtuar me ngarkim në kamion dhe transport deri në deponi të licencuar , furnizimi i pahisë së re me të gjitha elementet – tipi i njejtë me pahinë e vjetër dhe vendosja e pahisë sipas normave teknike . Paga bëhet për m të pahisë elastike të vendosur .

7.16 Pahi elastike anësore e re

Pozicioni përfshinë : demontimin e pahisë së dëmtuar me ngarkim në kamion dhe transport deri në deponi të licencuar , furnizimi i pahisë së re me të gjitha elementet – tipi i njejtë me pahinë e vjetër dhe vendosja e pahisë sipas normave teknike . Paga bëhet për m të pahisë elastike të vendosur .

7.17 Pahi elastike anësore e re në rrugët kyqëse .

Pozicioni përfshinë : demontimin e pahisë së dëmtuar me ngarkim në kamion dhe transport deri në deponi të licencuar , furnizimi i pahisë së re me të gjitha elementet – tipi i njejtë me pahinë e vjetër dhe vendosja e pahisë sipas normave teknike . Paga bëhet për m të pahisë elastike të vendosur .

Sinjalistika Horizontale

Ripërtirja e sinjalizimit horizontal (vija e plotë , vija e ndërprerë , shigjetat e orjentimit , ujëdhesat etj .) (i plastifikuar)

7.17 Vija e plotë e bardhë , b=20cm e plastifikuar . Paga bëhet për m .

7.18 Vija e ndërprerë e bardhë b=20cm e plastifikuar . Paga bëhet për m .

7.19 shigjetat e orjentimit , ujëdhesat etj .) (I plastifikuar). Paga bëhet për m2 .

8.Mirëmbajtja e gardhit rrethues

Inspektimin i të gjitha rrethimeve/gardheve do të ndërmerret si pjesë e inspektimeve të rregullta (shërbimi patrullë), sezonale, vjetore, kryesore dhe periodike. Inspektimet do të regjistrohen dhe plotësohet me fotografi me datë. Gardhet e shkatërruara do të zëvendësohen menjëherë, jo më vonë se 48 orë pasi është zbuluar defekti dhe në përputhje me kërkesat e prodhuesit. Gardhet e dëmtuara me funksionalitet të dëmtuar duhet të riparohen ose zëvendësohen jo më vonë se 10 ditë pasi është zbuluar defekti.

Gardhi Kufi i Auto udha - referohu kërkesave të prodhuesit

Gardhet në mbikalimeve - referohu kërkesave të prodhuesit

Parmakë për t'u mbështetur (handrails) - referohu kërkesave të prodhuesit.

8.1 . Riparimi i dëmtimeve të gardhit rrethues . pagesa bëhet për të gjitha operacionet dhe furnizimin me material . Pagesa bëhet për m² të gardhit të riparuar .

8.2 Punimi i gardhit të ri rrethues . Pozicioni përfshinë : largimin e gardhit të dëmtuar , furnizimi me material për punimin e gardhit të ri dhe punimi i gardhit të ri me material dhe dimensione sikur edhe gradhi i vjetër. Pagesa bëhet për m' të gardhit të punuar.

9. Mirëmbajtja e sistemit të ndriçimit

Inspektimi –Elementet e ndriçimit rrugor përfshijnë kabinat, vend postimit, ndriçuesit dhe vend ndriçimet, linjat kablore dhe qarqet dhe pajisjet matëse të ndriçimit rrugor në TS

Siguria e punëtorëve dhe e pjesëmarrësve në komunikacion është e një rëndësie të veçantë gjatë inspektimit dhe mirëmbajtjes se ndriçimit të rrugëve. Inspektim i rregullt :

Ndriçues, vend ndriçimet, linjat kablore, qarqe dhe pajisje matëse në TS - një herë në gjashtë muaj Operimi dhe pastrimi (papastërtinë nga ndriçuesit dhe vend ndriçimet - një herë në tre muaj

Inspektim Periodik : Pas fatkeqësive të mëdha të motit (apo stuhitë, shkarkimet atmosferike, bore,).

Punime Mirëmbajtje : Riparimi dhe ndrrimi i pjesëve të ndriçimit - sa më shpjetë që është e mundur . sipas nevojës

10.2.Telekomunikimet

Në këtë fazë të projektit janë shtruar vetëm tubat të cilat në të ardhme do të mbajnë kabllo me fibër optike. Mirëmbajtja përfshin të gjitha aktivitetet e nevojshme për të përcaktuar gjendjen e sistemit dhe për të mbajtur sistemin teknikisht në gjendje të mire. Pasi të instalohet sistemi i telekomunikacionit ky kapitull do të ndryshohet sipas nevojës.

Pusetat përgjatë rrugës se tubacioneve duhet të inspektohen rregullisht si pjesë e inspektimit sezonale të Auto udha për të pastërtisë llum dhe uje. Duhet të kontrollohet funksionimi i të gjitha pjesëve (dmth. mbërthime, kapakë). Llumi dhe uji duhet të hiqen me pompe dhe i gjithë dëmi të riparohet në kohën më të shkurtër të mundshme.

11. Mirëmbajtja e rrugëve ndihmëse , përgjatë rrethojës së autoudhës (rrugët makadam).

11.1 Nivelimi dhe ngjeshja

Rrugët ndihmëse makadam duhet të mirëmbahen. Gropat dhe deformimet duhet të sanohen. Nivelizimi, planifikimi bëhet me grejder , kurse ngjeshja bëhet me cilindra 8-10tonë.

11.2 Furnizimi i materialit , tampon 0-31.5mm , shtrirja dhe ngjeshja t=10cm

Pozicioni përfshunë : Furnizimin me material – guror , fraksion 0-32 mm , transporti deri te vendi I vendosjes , shtrirja , nivelizimi dhe kompaktimi I tamponit .Shtrirja bëhet me grejder kurse ngjeshja bëhet me cilindra 8-10tona.

12 . KUJDESTARIA gjatë 24h (për Ruajtjen e Autoudhës dhe rrugës N9 , nga dëmtimi dhe vjedhja e pajisjve, inventarit dhe pjesëve tjera) , gjatë tërë periudhës së mirëmbajtjes Rutinëdhe dimërore.

Detyrat : Monitorimi i Auto udhës 24h , gjatë tërë mirëmbajtjes Rutinëdhe dimërore . Parandalimi dëmtimeve dhe vjedhjeve të aseteve të Auto udhës . Komunikimi permanent me shërbimin policor .Automjeti i cili

kujdestaron duhet të jetë i shënuar "Sigurimi dhe ruajtja e Auto udhës ". Personat e angazhuar në ruajtjen e Auto udhës duhet të kenë uniformë dhe kartë identifikimi me të cilën identifikohet se është i angazhuar në ruajtjen e Auto udha. Për dëmtimet dhe vjedhjet eventuale të aseteve të Auto udhës do të jetë përgjegjës operatori i angazhuar për mirëmbajtjen e Auto udhës .

Operatori ekonomik i mirëmbajtjes së Auto udhës mund të bëjë marrëveshje me ndonjë kompani të licencuar , për sigurimin e objekteve, për kujdestari gjatë 24h (për Ruajtjen e Auto udhës , nga dëmtimi dhe vjedhja e pajisjeve, inventarit dhe pjesëve tjera) , gjatë tërë periudhës së mirëmbajtjes Rutinëdhe dimërore.

13 .Regjistrimet dhe Inventarizimit

Të dhënat e regjistruara

Për të gjitha inspektimet duhet të mbahet një raport inspektimi në formatin e miratuar nga MI.

Të gjitha matjet e mbledhura dhe defektet e identifikuar gjatë inspektimit do të raportohen dhe regjistrohen, duke përfshirë detaje të çdo veprimi të ndërmarrë ose të kërkuara.

Të gjitha të dhënat do të ruhet për një minimum prej shtatë vjet dhe do të asgjësohen vetëm me miratim të shkruar të MIT. Këto regjistrime do t'i dorëzohen MIT-it, ose përfaqësuesve të tyre në përfundim të marrëveshjes me ekipet e Mirëmbajtjes.Një raport vjetor, përfshirë një përmbledhje të inspektimeve, operacioneve të mirëmbajtjes rutinë dhe ndryshime në rrjet do t'i jepen MIT-it në fund të vitit financiar. Pjesët përkatëse të këtij raporti do të përfshihet në Planin e Biznesit të Ekipit.

Ky pozicion nuk paguhet veçmas , por përfshihet në kuadër të çmimeve të pozicioneve të paramasës .

PUNËT DITORE

Çdo punë që kërkohet urgjentisht dhe që nuk është e listuar në Paramasën dhe Paralogarinë dhe e specifikuar këtu si punë emergjence, riparime mbi struktura për të parandaluar dëmtime të mëtejshme, do të kryhen mbi një bazë pune ditore duke përcaktuar punën dhe pajisjet, nëse kërkohet.

Këto punë do të aprovohen në mënyrë të qartë me shkrim nga Projekt Menaxheri para se Kontraktuesi të marrë masat individuale. Nëse kjo ndodh, koha për punën dhe pajisjet e përdorura për të kryer punët ditore do të shënohen në tabela të përgatitura dhe nënshkruara nga Kontraktuesi dhe të aprovuara dhe nënshkruara nga Projekt Menaxheri.Njësia e orës së secilit punëtor duhet të përfshijë të gjitha elementet e kostos siç përshkruhet në Paramasës dhe Paralogarisë për punime ditore dhe do të përfshijë të gjitha pajisjet dhe materialet që do të përdoren gjatë kryerjes së punëve.

E njëjta gjë i referohet mjeteve dhe pajisjeve kryesore, kostove për karburante dhe lubrifikantë, pjesë rezervë, riparime dhe amortizimin si dhe pagat për shoferët, operatorët dhe ndihmësit të gjitha këto do të përfshihen në njësinë e orës. Materialet e përdorura gjatë kryerjes së masave të punëve ditore do të regjistrohen dhe listohen; ato do të përdoren në mënyrën më ekonomike dhe profesionale në mënyrë që të parandalohet çdo keqpërdorim apo humbje.

Skicat "As Built " (vizatimet e gjendjes e ekzekutuar) do të mbahen të përditësuara nga ekipet e Mirëmbajtjes.

III- SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR MIRËMBAJTJEN DIMËRORE TË AUTOUDHËS A7 (IBRAHIM RUGOVA),

AUTOUDHËS A7(SEGMENTI :BRESJE-BESI),RRUGËS NACIONALE N9(SEGMENTI:BESI-GJURGJICË),UDHËKRYQIT TË AUTOUDHËS A7/A6 - DERI NË KONJUH DHE KYQJA ME RRUGËN NACIONALE N2)- LOT 2.

PËRMBAJTJA :

Hyrje

1.Përkufizimet

2.Punët e Mirëmbajtjes Dimrore

3 Punët Përgatitore

3.1 Plani dhe Programi i Veprimit

3.2 Planet për Pastrim dhe Shpërndarje

3.3 Bazat e Mirëmbajtjes dhe deponimi i kripës

3.4 Rroba të Dukshme , Automjete dhe Pajisje te Shënuara

3.5 Paralajmërime për Akullin e Zi në Zonat e Rrezikut

3.6 Mbrojtëse e Borës

3.7 Sinjalizimi i trafikut

3.8 Pajisjet për Mirëmbajtjen Dimërore- Automjetet për shpërndarje

3.8.1 Automjetet

3.8.2 Pajisjet për Shpërndarje

3.8.3 Paisjet per Pastrim (Pllugjet për borë)

4. Organizimi dhe kryerja e shërbimeve të mirëmbajtjes dimrore

4.1 Menaxheri I Projektit (kontratës)

4.2 Vëzhgimi dhe Raportimi

4.3Pastrimi i Borës

4.4 Largimi i gureve te rëne , materialit të erodua dhe mbeturinave nga rruga

4.5 Menaxhimi i përkohshem i trafikut për Mirëmbajtje dhe Emergjencia

5. Matjet dhe Pagesat

Automjetet - Oret efektive dhe të udhëtimeve

Koha e kujdestarise 24 ore

Materialet per shperndarje

Sinjalizimi i trafikut, mbrojtset e bores

Vendosja dhe largimi i Sinjalizimit te Trafikut

Vendosja dhe largimi i Udhërrëfyesit te Borës

Mbrojtëset e Borës

Punët Ditore

Shtojcat

Paisjet e Obligueshme

II. SPECIFIKIMET TEKNIKE

PËR MIRËMBAJTJEN DIMËRORE TË AUTOUDHËS A7 (IBRAHIM RUGOVA) ,

AUTOUDHËS A7(SEGMENTI :BRESJE-BESI),RRUGËS NACIONALE N9(SEGMENTI:BESI-GJURGJICË),UDHËKRYQIT TË AUTOUDHËS A7/A6 - DERI NË KONJUH DHE KYQJA ME RRUGËN NACIONALE N2)- LOT 2.

Hyrje

Moti në dimër shpesh është i paparashikueshëm dhe kërkon një qasje fleksibile në sigurimin e shërbimeve. Kushtet dhe siguria në rrugë gjatë dimrit janë dukshëm të kufizuara nga bora dhe akulli. Të gjitha masat e ndërmarra për të kundërvepruar ndaj pasojave të borës dhe akullit mund të përshkruhen si Shërbime për Mirëmbajtjen Dimërore.

Pastrimi i bores përfshin detyrat per shkrifetimin dhe transportin e bores se hequr. Ndryshe nga uji, bora mund të ngjeshet por nuk është elastike. Kur bora ngjeshet ajo e ruan formën e vet. Për këtë arsye është teper e rëndësishme largimi i saj ne kohë. Shërbimet e Mirëmbajtjes Dimërore janë në të mire të sigurisë në rrugë dhe jane shumë të rëndësishme për ekonominë kombëtare.

1.Përkufizimet

Kur ashpersia e siperfaqes se rruges zvogelohet për shkak të akullit ose borës atëherë kemi të bëjmë me kushte të ngricave. Këto shfaqen papritur dhe pa paralajmërim dhe shpesh here vetem në zona të caktuara.

Ne varesi te rrethanave, në rrugë mund të shfaqen situatat e meposhteme të ngricave dhe si të tilla janë të përkufizuara e përdorën në Kontratë:

Bora e ngrirë – kjo gjendje shkaktohet nga bora e ngjeshur nga automjetet, nga bora e shkelur e ngrire.

Ngricat – paraqiten kur lagështia atmosferike bie në siperfaqen qarkulluese te rruges dhe ngrin.

Akulli – shfaqet kur ngrin lagështia ekzistuese (që përshkruhen gjithashtu edhe si zona te lagështa dhe te ngrira).

Akulli i zi – shtresë homogjene e akullit që shkaktohet nga shiu i akullit ose nga shiu që bie mbi sipërfaqen e ngrirë të rrugës.

Punëdhënës është : Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit.

Menaxher i projektit (mbikëqyrës i punimeve) është personi i cili do të caktohet nga Ministria e infrastrukturës dhe Transportit .

Zbatimi i planit për mirëmbajtje dimërore mbikëqyret nga MIT/ Departamenti për Menaxhimin e Rrugëve - gjegjësisht nga Menaxheri i kontratës .

Ministria e Infrastrukturës e Transportit dhe Departamenti për Menaxhimin e Rrugëve koordinon aktivitetet e mirëmbajtjes dimërore me SH.P.K-në dhe KFOR-in dhe subjektet tjera .

Mesatarja e përgjithshme e reshjeve të borës në sezonën dimërore është përvetsuar të jetë 30 ditë.

Kohëzgjatja e kujdestarisë është 105 ditë .

Rrugët që do të mirëmbahen janë :

LOTI 1 , Përfshinë : Mirëmbajtjen e Autoudhës R7 – (Morinë – Gjurgjicë) , Segmenti 1-5, kyqjet dhe daljet në Autudhë , të gjitha strukturat dhe rrugën Lidhëse Rrethi në rrugën Rajonale R107 – Rrethi në Kyqjen e Auto udhës , L=2.36km .

III - Punët e Mirëmbajtjes Dimrore

Shërbime e Mirëmbajtjes Dimërore, përfshijnë:

Punimet përgatitore

Masat mbrojtëse kundër akullit të zi, akullit, grumbujve të borës dhe ortekëve,

Shpërndarjen e kripës.

Pastrimin e bores dhe largimin e akullit

Largimin e gurëve, dheut të rënë në rrugë dhe largimi mbeturinave nga rruga.

Menaxhimi i rasteve të jashtëzakonshme (aksidente komunikacioni dhe Rregullimi i komunikacionit , gjatë rasteve të jashtë zakonshme ,reshjeve të mëdha dhe aksidenteve).

Sigurimi i funksionimit të drenazhimit nga mbistruktura e Auto udhës .

Heqje e mbeturineve , automjeteve nga rruga

Largimi i kafshëve të ngordhura ose të aksidentuara.

Vendosja e sinjalizimit përkatës .

Informimi i publikut për gjendjen në Autoudhë dhe rrjedhën e trafikut.

3 . Punët Përgatitore

Në mënyrë që të sigurohet funksionimi i shërbimeve të mirëmbajtjes dimërore që në fillim të kësaj periudhe dimërore duhet të merren masat e mëposhtme:

Hartimi i planeve të shpërndarjes dhe pastrimit.

Përgatitja dhe caktimi i punktit për deponimin e materialeve për shkrirjen e borës dhe akullit , Akomdimin e stafit udhëheqës , punëtorëve dhe mekanizimit për pastrimin e borës dhe

Rezervat e materialeve shpërndarëse; e gjithë sasia e planifikuar duhet të jenë në rezervë para fillimit të periudhës së dimrit.

Kontrollimi i pajisjeve dhe automjeteve të mirëmbajtjes dimërore.

Vendosja e mbrojtëseve të borës në pikat potenciale ku bora formon përgje.

Vendosja e udhërrëfyesve të borës (udhërrëfyesit e ngjyrosur në të zezë/të verdhë)

Vendosja e shenjave paralajmëruese të rrezikut nga akulli në pikat e rrezikshme

Finalizimi i kontratave me nënkontraktoret.

Udhëzimi dhe trajnimi i fuqisë punëtore.

3.1 Plani dhe Programi i Veprimit

Vendodhjet (punktet) stand-by / në detyrë për shërbimin e mirëmbajtjes dimërore,

Niveli i stand-by,

Numrin e duhur të personelit, makinerive, dhe materialeve për përhapje, dhe rregullimin e tyre sipas vendodhjeve stand-by / detyre,

Orarin e ekzekutimit të punës, duke pasur parasysh prioritetet e përcaktuara nga plani.

Progresi i aktiviteteve individuale dhe punimeve,

Kontrolli dhe mbikëqyrja e aktiviteteve të shërbimit të mirëmbajtjes dimërore

Kushtet nën të cilat trafikut duhet të kufizohet ose të ndalohet për disa lloje automjesh, gjithçka për arsye të sigurisë në trafik,

Sistemi i komunikimit,

Vlerësimi i materialit stok të nevojshëm për të mbështetur kërkesat e mirëmbajtjes dimërore,

Metodat për të informuar publikun për gjendjen e rrugëve dhe fluksin e trafikut.

3.2 Planet për Pastrim dhe Shpërndarje

Zbatimi i shërbimeve të pastrimit të borës dhe shërbimeve të shpërndarjes paraqet nevojën e një planifikimi të saktë të rrugëtimit ditor gjatë ditëve me të reshura bore. Siç është e përcaktuar nga plani vjetor për mirëmbajtjen dimërore tri vjeqare(viti i parë 2019/2020).

3.3 Bazat e Mirembajtjes dhe deponimi i kripës

Kontraktuesi duhet të siguroj bazë të mirëmbajtjes duke përfshirë këtu zyre, strehë për automjete dhe pajisje si dhe depo të mbuluar dhe të mbrojtur nga depërtimi i lagështisë , për deponimin e kripës . Ketu duhet te perfshihet dhe nje zyre e ngrohur dhe e ndriçuar per Projekt Menaxherin (mbikëqyrësin) . Zyra duhet te jete e pajisur me tavoline dhe karrike, kompjuter dhe printer nevojshme, aparat telefonik dhe faksi (internet) per te ushtruar veprimtarine e përditshme te mbikëqyrjes se shërbimeve. Shpenzimet per ngritjen/marrjen me qira te zyles, furnizimin/mirëmbajtjen e pajisjeve dhe shpenzimet e ngrohjes dhe energjise elektrike i bartë Kontraktuesi. Kontraktuesi duhet të siguroj edhe parking për automjetet për pastrim dhe kujdestari dhe zyre për stafin udhëheqës të kontraktuesit dhe objekt për pushimin e punëtorëve .

3.4 Rroba të Dukshme , Automjete dhe Pajisje te Shënuara

Punëtorët e Kontraktorit duhet te veshin rroba pune të dukshme gjatë punës. Kjo është më se e nevojshme për shkak se mirëmbajtja dimërore bëhet kryesisht në kushte të vranëta atmosferike dhe errësirë.

Automjetet e mirëmbajtjes dimërore duhet të pajisen me dy drita paralajmëruese të rrotullueshme, vezulluese, me ngjyrë te verdhë dhe të shënohen me sinjale paralajmëruese. Ato duhet te jene te kuqe dhe te bardha dhe prej materiali reflektues.

Nëse dritat e gjata standarde janë të mbuluara nga bora e hequr prej pllugjeve atëherë duhet që automjetit ti vendosen drita shtesë në një lartësi të tillë që rruga të jetë e ndriçuar sa duhet gjatë qarkullimit normal si dhe gjatë pastrimit të borës.

3.5 Paralajmërime për Akullin e Zi në Zonat e Rrezikut

Kontraktuesi duhet të siguroj, sipas sygjërimeve te Menaxherit të projektit të bazuar në përvojën e tij shumëvjeçare, vendosjen e shenjave paralajmëruese për rrëshqitje në sipërfaqe të veçanta te rrjetit rrugor te cilat janë te prirura për formimin e akullit të zi.

3.6 Mbrojtëse e Borës

Nëse bora bien e qetë shtresohet në mënyrë të njëtrajtshme në sipërfaqe; mirëpo kjo do të çrregullohet nëse era fryn gjatë të reshurave të borës, gjë që do të shkaktojë grumbullimin e borës, të ashtuquajtura pirqje bore të cilat zakonisht formohen në pjesën kah fryn era.

Vendosja e mbrojtëseve të borës do ti parandaloj këto dukuri dhe zëvendëson mbrojtëset natyrore siç janë mbrojtëset me shkurre dhe bimët tjera.

Kalimet e rrugëve në terrenet e hapura janë më të rrezikuara në formimin e mëtutjeshëm të pirqjeve të borës posaçërisht në mbushje dhe prerje e cila zakonisht paraqitet në terrene të pjerrëta.

Në rastin kur kërkohet vendosja e mbrojtëseve të borës duhet të kemi kujdes që:

Mbrojtëset e borës duhet të vendoset në anën e djathtë në këndin e drejtë me drejtimin e erës. Lartësia duhet të jetë min. 1.30 m, max. 1.80 m, hapësira në mes fundit të mbrojtëses së borës dhe sip. së tokës është 30 cm.

Distanca nga rruga duhet të jetë 12 deri në 15 herë më e madhe se lartësia e mbrojtëses së borës (përafërsisht 22 m mesatarisht)

Mbrojtëset e borës duhet të fiksohen me tela diagonal të cilët vendosen në këndin e drejtë nga mbrojtëset e borës.

Mbrojtëset e borës duhet të vendosen sa më herët që është e mundur dhe vendosja e tyre duhet të përfundoj më së voni nga fundi i muajit Nëntor.

3.7 Sinjalizimi i trafikut

Në terrenet e hapura dhe/ose kur mbuloja e lartë e borës pritet që rezulton me zvogëlimin e dukshmërisë së skajit të rrugës, duhet të vendosen udhërrëfyesit e borës të ngjyrosura në të verdhë dhe të zezë, përfaqësimisht 50cm larg hapësirës e cila duhet të pastrohet. Distanca në mes të udhërrëfyesve mvaret nga lakueshmëria e rrugës, me fjalë të tjera përbrenda sektorëve të drejta distanca nuk duhet të jetë më e gjatë se 100m, në kthesa <100m. Nëse është e nevojshme shenjat duhet të vendosen në secilën anë të rrugës

Kontraktuesi duhet të ketë parasysh vendosjen e përkohshme të shenjave paralajmëruese (të siguruara pjesërisht nga punëdhënësi) me simbole rrëshqitjeje në ato vende të rrjetit të rrugëve M dhe R, ku priten krijimi i sipërfaqeve rrëshqitëse të rrugës nga akulli dhe nga ngrica. Lloji, materiali dhe dimensionet e shenjave janë si më poshtë:

Në përgjithësi shenjat duhet të jenë të njëjta me ato ndërkombëtare të shpallura nga "Konventa e Shenjave & Sinjaleve Rrugore" (Vienë).

Forma trekëndëshe, me secilën brinjë nga 90 cm

Pllaka metalike prej fletë metalike çeliku 2 mm e trashë, e plastifikuar dhe reflektuese ndaj dritës.

Shtylla prej gyp çeliku, e galvanizuar me diametër minimale prej 80 mm.

Baza katrore prej shufra çeliku të pjerrëta, të galvanizuara 50 x 50 cm

Lartësia 2.00 m në mes fundit të pllakës metalike dhe skajit të bankinës.

3.8 Pajisjet për Mirëmbajtjen Dimërore- Automjetet për shpërndarje

3.8.1 Automjetet

Për shpërndarjen e materialeve të sipërpërmendura duhet përdorur kamionë me kapacitet bartës minimum 6 tonë. Kamionët nuk duhet të stërngarkohen dhe duhet t'u bëhet servisi i rregullt (min. për çdo 5000 km) për të qenë në gjendje të mirë shërbyese.

Kontraktuesi do të angazhojë në punë me këto makina vetëm shoferë të kualifikuar e me përvojë dhe ata duhet të kujdesen për kryerjen e servisit të rregullt ditor e periodik.

Kontraktuesi do të dorëzojë shënimet që vërtetojnë servisin e rregullt ndërsa MIT/ Departamenti për menaxhimin e Rrugeve, mbajnë të drejtën për inspektimin e makinave në çdo kohë.

Automjetet duhet të jenë të gatshme ditë e natë, edhe gjatë të dielave dhe pushimeve. Gjatë pastrimit të borës automjetet duhet të jenë të ngarkuara në menyre të mjaftueshme; ngarkimi dhe shkarkimi i kripës si dhe vendosja dhe heqja e borëheqësve/pllugjeve dhe makinave shpërndarëse është përgjegjësi e Kontraktuesit.

Përveç kësaj automjetet duhet të jenë të pajisur me zinxhirë bore që duhet të vendosen nëse është e nevojshme.

3.8.2 Pajisjet për Shpërndarje

Materiali (kripa industriale) shpërndahet nga një shpërndarës automatik .

Ekzistojnë dy lloje të shpërndarësve për përdorim:

Një rimorkio i cili është i përbërë nga një kontenjer dhe një shpërndarës; sasi të kripës të cilat duhet të shpërndahet dhe përshtatet në rregullator, ndërsa gjërsia shpërndarëse në shpejtësinë e pllakës rrotulluese është e pandryshueshme.

Pllaka shpërndarëse e montuar në kamion; sasia e kripës e cila duhet të shpërndahet dhe gjërsia shpërndarëse mvaren nga shpejtësia e pllakës rrotulluese.

3.8.3 Pajisjet për Pastrim (Pllugjet për borë)

Për ta pastruar borën, duhet përdorur pllugje efikase të borës. Përdoren pllugje të çelikut të cilat montohen në pjesën e përparme dhe me lehtësi në kamiona. Pllugjet e borës duhet të ngriten e të ulen në mënyrë pneumatike ose hidraulike.

Gjërsia e pllugjeve duhet të jetë së paku 0.40 m më e madhe se gjërsia e automjeteve. Së këndejmi gjërsia e pllugut për pastrimin e sipërfaqes qarkulluese borës është 2.90 m për sipërfaqen qarkulluese të rrugës.

Pllugjet me tehun e lakuar ose këndor e ngrenë borën nga niveli i tokës. Derisa pllugu lëviz përpara, shtresa e borës ngritet lartë nga tehu duke u formësuar në një stom anash rrugës. Kjo i formon muret anësore të cilat duhet hequr posaqrisht në vendet që i nënshtrohen erës dhe ku pritet rrëzimi i tyre ose në pjesë të ngushtimit të rrugës.

Kapaciteti i motorit të automjeteve që shërbejnë për montim të pllugjeve të borës duhet t'i përshtatet kushteve të përgjithshme të borës si dhe vendit. Ky kapacitet duhet të sillet ndërmjet 73.5 kw (100 KF) dhe 190 kw (260 K) Duhet të përdoren pllugje që e pastron borën në një anë.

Numri i automjeteve dhe Pajisjeve kryesore , për largimin e borës dhe shpërndarëset e kripës epen në vijim:

Pajisjet bazike minimale	Automjete kamiona	Borëheqëset (Pllugjet)	Shpërndarësat automatik të kripës
	Nr.	Nr.	Nr.
LOT 2	10	10	10

4. Organizimi dhe kryerja e shërbimeve të mirëmbajtjes dimrore

4.1 Menaxheri i Projektit (kontratës)

Manaxheri i projektit është perfaqësues i autorizuar i Autoritetit Kontraktues për kontrollin e cilësisë dhe sasisë së kryerjes së shërbimeve të kontratës . Manaxheri i projektit koordinon veprimet dhe raporton në organe të tjera përgjegjëse jashtë : Departamentin për Menaxhimin e Rrugëve / Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit , SH. P. K. dhe KFOR-i.

Çdo veprim që kryhet apo duhet lejuar të kryhet dhe çdo dokument që kërkohe apo duhet të zbatohet në kuadër të Kontrates nga ana e Ofruesit të Shërbimeve urdherohet apo ekzekutohet nga ana e Manaxherit të projektit

4.2 Vëzhgimi dhe Raportimi

Baza e mirëmbajtjes do të jenë në kontakte të përhershëm me stacionet meteorologjike të Kosovës që të marrin informacionin përkatës për parashikimet e motit në atë rajon. Përveç kësaj rrjeti rrugor duhet të kontrollohet vazhdimisht, ditë e natë, nga personeli i mirëmbajtjes dimrore të Kontraktuesit. Çdo dukuri që ndikon në

kushtet e rrugës gjatë dimrit duhet të raportohet nga ekipet menjëherë bazës dhe Projekt Menaxherit. Per kete duhet ete vendoset nje linje komunikimi midis Kontraktuesit dhe Projekt Menaxherit me radio lidhje ose telefon mobil. Shpenzimet per paisjet e komunikimit i mbart Kontraktuesi.

Këto vëzhgime dhe masat e nevojshme për të ndaluar ose luftuar rrethanat e mundshme të ngricës do të regjistrohen në ditarë duke shënuar dhe vendin ku është bërë vëzhgimi. Ditari duhet të përfshijë gjithashtu kushtet ditore të motit si dhe temperaturat maksimale dhe minimale, gjatësia dhe lartësia e reshjeve të borës, intensiteti i shiut me akull, etj. Raportet duhet të dorëzohen tri here Brenda ditës dhe duhet ti adresohen Projekt Menaxherit, Departamentit për Menaxhimin e Rrugëve dhe Departamentit të Infrastrukturës Rrugore .

Raportimi mund te kryhet me telefon, fax ose me poste elektronike (e-mail).

Ne veçanti për automjetet Kontraktuesi është i detyruar të mbajë libra llogarie për të regjistruar kohën dhe destinacionin e udhëtimeve që do të përdoret - bashkë me tahografët e automjetit- si bazë e matjes dhe pagesës. Gjithashtu për qëllime të matjeve dhe pagesës si dhe mbikqyrjen e sasive, secili kamion do të furnizohet me një formular dokumenti të njohur si "Raporti për Shpërndarje dhe Pastrim " (një shembull i tillë i formularit është i treguar ne fund e ketyre specifikimeve). Origjinali do ti dorëzohet më së voni të nesërmen Menaxherit të projektit për konfirmim dhe pranim ndersa dy kopje do te mbesin tek Kontraktuesi.

4.3 Pastrimi i Borës

Shtresa e bores mund të jetë me fortësi të ndryshme.

Përpjekja që duhet bërë për të menjanuar borën rritet sa me e ngjeshur që te jetë ajo. Kripërat shkrirëse të shpërndara në borën e rënë zvogëlojnë aftësinë e borës për tu ngjeshur në sipërfaqet e rrugës dhe të formoj shtresa të forta. Procesi fiziko-kimik i zbatuar me kripë, e ulë vëllimin e punës mekanike për ta pastruar borën.

Kjo rezulton në udhezimet bazë të mëposhtme që duhet të ndiqen me përpikshmëri nga Kontraktuesi që do të ndërmarrë kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes dimërore:

Bora duhet të pastrohet para se të forcohet ose të ngjeshet nga trafiku.

Për të lehtësuar pastrimin duhet të shpërndahet kripë në borën e rënë (të papastruar) në mënyrë që të shmanget ngjeshja e saj në një shtresë të fortë.

Bora duhet të largohet për sa kohë që është e lagur dhe e pangjeshur. Kjo do të parandaloj krijimin e një shtrese të fortë dhe të ngjeshur.

Pastrimi i borës duhet të filloj kur trashësia e saj është 3-5 cm.

Sëpari pastrohen shiritat qarkullues dhe kyqjet në auto udhë pastaj shiriti ndihmës (shiriti për ndalim dhe parkim).

Në rrugën N9 , sëpari pastrohen shiritat qarkullues dhe rrugët e nënkalimeve e pastaj shiritat për ngadalësim .

Vendet për ndaljen e autobusëve, zonat e parkimit dhe anët e bankinave duhet të pastrohen pas sipërfaqes qarkulluese të rrugës.

Pastrimi i borës përfshin gjithashtu pastrimin e bankinave , kanaleve dhe rigolave .

Rendi i pastrimit dhe përhapjes është si vijon :

Përhapja dhe pastrimi i borës nga korsitë e trafikut.

Përhapja dhe pastrimin e borës nga krahët e kryqezimeve

Përhapja dhe pastrimin e borës nga rrugët lidhëse të autostradës, zonat e tjera, parkingjet.

Përhapja dhe pastrimin e borës nga koristë e emergjencës.

Parimi i njejtë vlen edhe për rrugën N9.

Heqja e borës do të fillojë brenda 30 minutave kur fillon të bjere bora. Të gjitha korsitë, si dhe rrugët lidhëse me autostradën duhet të pastrohen brenda një periudhe prej dy orësh pas njoftimit të kushteve të dëborës.

Cikli i rotacionit të mjeteve të pastrimit të dëborës do të jetë 120 minuta.

Sipërfaqja qarkulluese me disa korsi, do të pastrohen me plugje dëbore që hedhin dëborë në anën e djathtë .

Në rast akulli, të trajtohet sipërfaqja me materiale të përshtatshme sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më shumë se 15 minuta pas zbulimit.

Gjatë periudhave kur ngricat dhe/ose kushtet e akullta parashikohen, Operatori do të marrë masat e duhura për të parandaluar kushtet për rrëshqitshmëri.

Në kushtet e dëborës dhe rrjedhave normale të komunikacionit, Autoudha do të jetë plotësisht e pastruar 1 orë pasi ka përfunduar rënia e borës gjatë ditës dhe natës. Në rast të rreshjeve të forta objektivi do të jetë për të hapur të paktën një korsi për trafikun në secilin drejtim të autostradës, me trafikun e organizuar në varg prapa makinës borë pastrues.

Kur bëhet pastrimi, ai duhet të bëhet tek asfalti, që do të thotë pastrim nga bora e korsive duke pluguar dhe përhapur agjentët që shkaktojnë tretjen.

Korsitë e emergjencës mund të pastrohen gjithashtu nëse ka përfunduar pastrimi i të gjitha sipërfaqeve të tjera dhe nuk ka nevojë për pastrim të mëvonshëm.

Bora është pastruar nga sipërfaqja e tërë e korsisë së trafikut. Gjithashtu, të gjitha korsitë do të spërkatën në të njëjtën kohë me përhapës, edhe kur nuk mund të pastrohet e gjithë gjerësia e trasesë.

Nëse rreshjet e forta dhe permanente të borës pengojnë pastrimin e sipërfaqes qarkulluese në periudhën e caktuar kohore ose aspak (për shkak të reshjeve të mëdha të borës) sipërfaqja qarkulluese do të pastrohet duke përdorur edhe makineri klasike (kamionë dhe automjete multifunksionale të pajisura me përhapës për përhapjen e thatë dhe të lagësht dhe plug dëbore). Gjithashtu do të përdoren makineri bluarëse si dhe makineri të tjera ndërtimi në dispozicion (eskavator , ngarkues etj). Ato do të përdoren edhe kur bora nuk mund të hidhet mbi parrmakët e betonit (viaduktet, ura, kanalet nën rrugë, mbikalimet, kryqëzimet).

Sipërfaqet e tjera të trafikut (rrugët afruese dhe lidhëse në zonat e pushimit dhe parkingjet, qasjet tek telefonat e emergjencës, sheshpushimet, qasjet tek koshat e plehrave etj) do të pastrohen dhe do të përhapet material (dhe më pas nëse është e nevojshme) të gjitha në përputhje me rëndësinë e tyre në lidhje me trafikun. Vetëm në sipërfaqet e pastruar nga bora mund të përhapet material.

Kompania që kryen shërbimin e mirëmbajtjes së rrugëve në segmentet tjera të Auto udhës , duhet të bashkërendojnë programet e tyre me njëri-tjetrin dhe me persona të tjerë juridikë brenda zonave të juridiksionit, veçanërisht në lidhje me aksesueshmërinë e rrugëve dhe planifikimit e rrugëve alternative, në rast se rruga është e mbyllur për trafikun.

4.4 Largimi i gureve të rëna , materialit të eroduar dhe mbeturinave nga rruga

Te gjitha rruget qe perfshihen ne kete mirembajtje dimerore duhet te mbikqyren ne lidhje me pengesat qe mund te krijohen nga rreshqitjet e dheut, gureve apo edhe kafsheve te ngordhura mbi shiritat qarkullues. Gjithashtu duhet te largohen dhe materialet reshqitese ne seksionet ne prerje ku mendohet se mund te behen pengesa te mundshme te qarkullimit rrugor gjate dimrit. Sidoqofte urdheri per sherbime te tilla do te jipet nga Projekt Menaxheri.

4.5 Menaxhimi i perkohshem i trafikut per Mirembajtje dhe Emergjenca

Barrierë e heqshme

Barrierat e heqshme janë siguruar në vende strategjike për të ndihmuar me instalimin e Sistemeve të Menaxhimit të Përkohshëm të Trafikut.

masat paraprake (gardhet e bores, tabelat e bores)

përgatitja e planit të veprimit dhe informimit

sistemin e monitorimit dhe raportimit te kushteve.

5. Matjet dhe Pagesat

Më poshtë janë përshkruar metodat e matjeve dhe pagesave të cilat do të përdoren për sherbime te ndryshme. Ato korrespondojnë me pozicionet kryesore te aktiviteteve te sherbimit te paraqitura ne Paramase.

Automjetet - Oret efektive dhe te udhetimeve

Referoju tek Paramasa Nr. 1, Automjetet, Pozicioni 1.1

Matja duhet të bëhen me orët e kohës së punës aktuale siç është pastrimi, shpërndarja ose kombinimi i pastrimit dhe shpërndarjes si dhe koha e shpenzuar gjatë udhëtimit prej bazës së mirëmbajtjes deri në vendin e punës .

Çmimi njësi për orë do të përfshijë:

çmimi i makinistit/shoferit dhe ndonjë personeli shtesë ose shoqërues

shpërndarja e kripës ,montimi dhe çmontimi i borëheqësve/plugjeve ose ndonjë pajisje tjetër që mund të kërkohet për kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes dimërore.

përdorimi i borëheqëses/plugjeve dhe/ose makinës shpërndarëse/rimorkios së montuar, apo ndonjë paisje tjetër.

Shpenzimet karburantit dhe lubrikanteve

Servisimet, riparimet, gomat dhe pjesët rezervë

Pagesa do te kryhet ne baze te situacionit te paraqitur nga Kontraktuesi (numri i orëve të punës shumëzuar për çmimin njësi) mbasi te jete aprovuar nga Menaxheri i Projektit .

Referoju tek Paramasa Nr. 4 (Punët Ditore) , Pozicioni 4.3.7.

Matja duhet të bëhen me orët e kohës së punës aktuale siç është hedhja e bores me bore hedhese me shume se 10 metra si dhe koha e shpenzuar gjatë udhëtimit prej bazës së mirëmbajtjes deri në vendin e punës.

Çmimi njësi për orë do të përfshijë:

çmimi i makinistit/shoferit dhe ndonjë personeli shtesë ose shoqërues

hedhja e bores, montimi dhe çmontimi i borëhedhjes ose ndonjë pajisje tjetër që mund të kërkohej për kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes dimërore.

përdorimi i borëhedhjes apo ndonjë paisje tjetër.

Shpenzimet karburantit dhe lubrifikanteve.

Servisimet, riparimet, gomat dhe pjesët rezerve.

Pagesa do të kryhet në bazë të situacionit të paraqitur nga Kontraktuesi (numri i orëve të punës shumëzuar për çmimin njësi) mbasi të jetë aprovuar nga Menaxheri i Projektit.

Koha e kujdestarise 24 ore

Referoju të Paramasa Nr. 1, Automjetet, Pozicioni 1..2

Për kohën e "kujdestarise" kur kamionët mbesin në bazë të mirëmbajtjes; pagesa do të bëhet vetëm për ditët kur kamioni nuk është i angazhuar për shërbimet e mirëmbajtjes dimërore. Njesia është dite x kamion. Periudha e pritjes fillon me 15. Nëntor dhe përfundon me 31 Mars të vitit pasardhës; me fjalë të tjera numri i përgjithshëm i ditëve të dimrit arrijnë në 135, ndërsa numri mesatar i ditëve të kujdestarise për secilin kamionë = $135 - 30 = 105$ ditë. (ku 30 ditë është konsideruar mesatarja e përgjithshme e reshjeve të borës në stinën dimrore). Koha e kujdestarise 24 orë për ditë. Koha e kujdestarise, për një kamion llogaritet: $105 \text{ (DITË)} * 1 = 105$ (që në paramasë shprehet me DITË.).

Çmimi njësi do të përfshijë:

çmimi i gadishmerise të makinistit/shoferit dhe ndonjë personeli shtesë ose shoqërues

çmimi i gadishmerise së automjeteve dhe paisjeve

shpenzimet e udhëtimeve të vëzhgimit ditor të gjendjes së Auto udhës dhe rrugës.

polisat e sigurimit (për automjetet, pasurine dhe personat

shpenzimet e përdorimit të bazës së mirëmbajtjes

shpenzimet për komunikimin dhe raportim

Pagesa do të kryhet në bazë të situacionit të paraqitur nga Kontraktuesi (numri x dite x kamioneve shumëzuar për çmimin njësi) mbasi të jetë aprovuar nga Menaxheri i projektit (mbikëqyrësi)

Materialet për shpërndarje

Furnizimi dhe deponimi i kripës përfshinë:

Furnizimin dhe deponimin e kripës industriale në depo të mbuluara dhe të mbrojtura nga reshjet atmosferike dhe lagështia.

Furnizimi, ngarkimi dhe transporti i kripës

Referoju tek Paramasa Nr. 2, Materialet per Shperndarje, Pozicioni : 2.1 dhe 2.2

Matja do të jetë në kg dhe çmimi do të përfshijë:

Furnizimi me kripë industriale

Ngarkimi në makinat shpërndarëse

Transportimi ne vendin e shperndarjes

Shpërndarja e kripës me shpërndarës me dozer të sasisës së shpërndarjes (gr/m²).

Fuqia puntore përcjellëse .

Pagesa për furnizimi , ngarkim dhe transportim do të jetë në kg siç është e regjistruar në Raportet ditore për Pastrim dhe shpërndarje shumëzuar për çmimin njësi të Paramasës dhe Parallojarisë.

Sinjalizimi i trafikut, mbrojtset e bores

Vendosja dhe largimi i Sinjalizimit te Trafikut

Referoju tek Paramasa Nr. 3, Sinjalizimi i trafikut, mbrojtset e bores, Pozicioni 3.1.1

Matja do të bëhet per cope, çmimi do të përfshijë:

shpërndarja në pikat e rrezikut

vendosja

largimi dhe deponimi i tyre

Pagesa do të bëhet në cope shumëzuar me çmimin e Paramasës dhe Parallojaritë.

Vendi për deponimin e shenjave do të caktohet nga Menaxheri Regjional.

Vendosja dhe largimi i Udhërrëfyesit te Borës

Referoju tek Paramasa Nr. 3, Sinjalizimi i trafikut, mbrojtset e bores, Pozicioni 3.2.1

Kontraktuesi duhet të këtë parasysh vendosjen e përkohshme të udhërrëfyesve (të siguruara nga punëdhënësi) të borës në ato pika të rretit rrugor Magjistrat dhe Regjional që sugjerohen nga Menaxheri Regjional.

Matja do të bëhet per cope, çmimi do të përfshijë:

shpërndarja në pikat e rrezikut

vendosja

largimi dhe deponimi i tyre

Pagesa do të bëhet në cope shumëzuar me çmimin e Paramasës dhe Parallojaritë.

Vendi për deponimin e shenjave do të caktohet nga Menaxheri Regjional.

Mbrojtëset e Borës

Referoju tek Paramasa Nr. 3, Sinjalizimi i trafikut, mbrojtëset e bores, Pozicioni 3.3 dhe 3.3.1

Kontraktuesi duhet të ketë parasysh vendosjen e mbrojtëseve të bores (të siguruara nga punëdhënësi) në ato segmente rrugore të rrugëve Magjistrale dhe Regjionale ku pritet formimi i pirgjeve të borës nga era.

Matjet duhet të jenë në metër gjatësi, çmimi duhet të përfshijë :

shpërndarjen

vendosjen (montimin)

largimin dhe deponimin; vendi i deponimit caktohet nga Menaxherii projektit.

Pagesa do të bëhet në metër gjatësi shumëzuar me çmimin e Paramasës dhe Paralogaritë.

Punët Ditore

Referoju per tek Paramasa Nr. 4, Punet ditore

Për çdo shërbim i cili kërkohej urgjentisht dhe nuk është e përfshirë në Paramasë dhe Paralogari matet dhe paguhet në baze të pozicioneve të punëve ditore. Nëse paraqitet nevojë për aktivitet të mëposhtme realizohen nëpërmjet punëve ditore:

largimi i pirgjeve të borës, shtresave të akullit dhe pengesave tjera

largimi i materialit të eroduar (rrëshqitës në seksionet në prerje).

gurët që rrëshqasin, pengesat në rrugë (kafshët)

largimi i mbeturinave

Largimi i automjeteve të aksidentuara nga profili qarkullues i rrugës dhe menaxhimi i komunikacionit në këto raste duke vendosë edhe shenja plotësuese të komunikacionit.

riparimi i përkohshëm i dëmtimeve të ballafaqohet me matjet individuale. Nëse ky është rasti atëherë koha për fuqinë punëtore dhe pajisjet të cilat shfrytëzohen për kryerjen e punëve ditore do të regjistrohen në faqe speciale ose tabela për punë ditore të cilat pregaditen dhe nënshkruhen nga Kontraktuesi dhe të cilat më tutje aprovohen nga Menaxheri i projektit.

Çmimi për orë për secilin punëtor dhe kryepunëtor duhet të përfshijë të gjitha elementet shpenzuese të mëposhtme:

Sigurimi, deponimin, transportimi, përdorimi dhe mirëmbajtja e të gjitha materialeve, automjeteve, pajisjeve, makinerisë dhe mjeteve të punëve.

Sigurimi dhe përkujdesja e personelit dhe puntorëve si dhe vendosja dhe transportimi i tyre.

Sigurimi dhe mirëmbajtja e shmangjeve të përkohshëm të trafikut, rregullave, barrierave, shenjave të trafikut etj, sipas udhëzimeve të Inxhinjerit.

Fillimi, matja, inspektimi dhe mbikqyrja.

Sigurimi, transportimi, përdorimi dhe mirëmbajtja e gjërave të shpenzueshme, lëndëve djegëse, ujit, drenazhit, rrymës dhe telefonit, përfshirë edhe ato gjëra që sipas Kontratës mund të kërkohen nga Menaxheri Regional apo personeli i tij i mundshëm.

Vonesat ose dëmtimet e shkaktuara nga kushtet atmosferike në punimet në kryerje e sipër, në mekanizmin e rendë, materialet dhe gjërat e shpenzueshme.

Shpenzimet e tejkaluara, në shpenzime dhe fitim.

E njëjta i referohet edhe automjeteve dhe pajisjeve të rënda, shpenzimeve të karburanteve, pjesëve rezervë, riparimeve dhe amortizimit si dhe, në çmim duhet të përfshihen edhe pagesat për shoferët, makinista dhe ndihmësat.

Materialet të cilat shfrytëzohen gjatë zbatimit të punëve ditore duhet të regjistrohen dhe futen në list; ato duhet të përdoren sa më ekonomikisht dhe profesionalisht në mënyrë që të menjahet çfarëdo keqpërdorimi apo humbje.

Punët ditore të lartpërmendura nuk janë të kufizuara mbrenda periudhës së kontratës e cila është e caktuar në të dhënat për Kontratë . Në rastet kur kushtet atmosferike janë të pavolitshme , ngjarje te jashtëzakonshme te motit apo vonesa në fillimin e punëve të mirëmbajtjes verore , këto punë mund të kryhen edhe pas përfundimit të Sezonit dimror. .

Shtojcat : viti 1

SHTOJCA A

Të gjitha aktivitetet e mirëmbajtjes, duke përfshirë monitorimin autostradë (shërbim patrulle), duhet të kryhen në përputhje me standardet e cilësisë të pranura ndërkombëtarisht dhe praktikave më të mira. MIT identifikon si minimumin e standardeve të praktikës më të mirë standardet e punimeve të mirëmbajtjes të aplikuar nga Autostradat Kroate, si më poshtë (standardet e lidhur me Auto udhën Kroate aplikohen si model):

Gjatësia e seksionit të patrulluar në dite LOT2 = 55 km

Frekuenca e patrullave - ditore 0-24 h

Burimi minimal / kërkesat e pajisjeve:

Patrullat kryhen nga një person i kualifikuar – OPERATORI I MIRËMBAJTJES SE RRUGËS

Patrullat bëhen në makina të pajisura me pajisjet e mëposhtme:

1	Aparat fotografik	2.17	Set kaçavidash
2	Set veglash	2.18	set çelësa papagall dhe çelësa unazë
2.1	Lopate	2.19	metër
2.2	Kazëm	2.20	bateri mobile
2.3	Shati	3	Materialet e duhura për riparim:
2.4	Grabujë	3.1	Thithës me kapacitet të lartë thithës

2.5	Sëpatë	3.2	50 kg kripë për ta shpërndarë në rrugë vetëm gjatë dimrit
2.6	Kompaktues manual asfalti	3.3	Dado dhe vida për riparim të sinjaleve rrugore
2.7	Kosë	3.4	1 kg gozhda
2.8	Sharrë	3.5	top teli të hollë
2.9	Fshesë	3.6	kovë për ujë - 10l
2.10	Fshesë me korent	3.7	Kanistër për uje -10l
2.11	Çekiç 1,5 kg	3.8	Bidon për karburant - 10l
2.12	Varre(çekiç) 5 kg	3.9	Disinfektant
2.13	Sharrë për metal	3.10	Doreza plastike – një përdorimshme
2.14	Pinca/darë përthyesë	3.11	Qese plehrash
2.15	Përthyes për shufra hekuri	3.12	Fikes zjarri, pako zjarrfikësi,
2.16	mistri		

SHTOJCA B

Kërkesat minimale të pajisjeve për punonjësit e mirëmbajtjes / kontraktorin e mirëmbajtjes:

	Strukturat	3.2	Automjetet dhe lidhjet:
1	Garazh	3.3	Automjet shumë qëllimesh
2	Punishte me dhomë magazinimi	4	Përhapës kripe
3	Stacion karburanti	4.1	Përhapës kripe - kombinuar -2,5 m3
4	Strukture furnizimi me energji elektrike	4.2	Përhapës kripe - kombinuar - 6 m3
5	Zone e mbyllur e magazinimit të kripës me platforme ngarkimi – kapaciteti 2000 t	4.3	Plug bore:
7	Qendra e Komunikimit me kontrollin e trafikut	4.4	4.5.1. Plug bore gjerësi operimi 4,2
8	Dhoma për stafin	4.5	Plug bore UNIMOG 2,6 m
9	Stafi i menjëhershëm	5	Automjetet pasagjerësh
2	Shofer – mekanik	5.1	Automjete dërgesash

2.1	Punëtorët e rrugës	5.2	Ngarkues me vegla
2.2	Automjetet dhe lidhjet:	6	UKV-radio:
3	Mjete rrugore me kabinë të zgjeruar	6.1	I lëvizshëm / portativ
3.1	Automjete mallrash me pajisje	6.2	Stacionar / fiks

Tabela përmbledhëse e furnizimit të Kripës

Referoju Paramases Nr. 2, Materialet për Shpërndarje, Pozicioni 2.1

Nr. i Fletës së Furnizimit	Data e Furnizimit	Gjithsejtë -Kg
Gjithsejtë kripa NaCl - (viti I-rë-2019/2020)		

IV : SHTOJCA /- Në vazhdim janë të bashkangjitura disa nga materialet e përdorura gjatë ndërtimit të Autostradave-

Materialet e përdorura për Mirëmbajtje të Autostradave - Materialet e përdorura për çdo riparim ose zëvendësim gjatë periudhës së mirëmbajtjes nga MIT-it, ose kontraktuesi i saj i Mirëmbajtjes, siç janë treguar në listën e prodhuesve, duhet të kenë cilësi të barabartë ose më të mirë.

Qëllimi i këtij dokumenti është nxjerrja e disa informacioneve rreth materialeve më të përdorura në Autostrada nga Manuali e Operacioneve dhe Mirëmbajtjes (MOM), standardet dhe specifikimet, për qasje të lehtë të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit (këtej e tutje e njohur si "MIT") ose kontraktorit të saj të Mirëmbajtjes. Kjo listë e nxjerrë nuk kufizon kërkesat e dokumenteve të MOM, të cilat janë dorëzuar për secilin seksion të hapur të Autostradës.

Kërkesat e Përgjithshme Teknike (KPT) për Punët Rrugore të vitit 2001, lëshuara nga Autoriteti Kroat i Rrugëve, janë specifikime të përdorura për Punët Ndërtuese të Autostradës Rruga 7 dhe Rruga 6. KPT duhet të zbatohet gjatë Operacioneve dhe Mirëmbajtjes së Autostradës, kudo që është e nevojshme.

KPT 2001 përbëhet nga 6 Libra të veçantë;

Libri 1 i Përgjithshëm

Libri 2 Gërrmime-Kullim- Mur betoni

Libri 3 Shtrimi i rrugës

Libri 4 Punë me beton

Libri 5 Tuneli (N/A)

Libri 6 Pajisja e Rrugës

Qëllimi i MIT-it është të mirëmbajë objektet sa më pranë gjendjes fillestare të ndërtuar ose përmirësuar.

Të gjitha punimet e mirëmbajtjes duhet të kryhen duke respektuar:

Kushtet e motit

Sigurinë dhe lehtësinë e trafikut

Të gjitha ligjet, rregulloret, standardet, specifikimet, dizajnet dhe normat në fuqi.

Kërkesat e prodhuesit për elementet dhe pajisjet pronësore.

Këtë Manual O/M

KPT (Kërkesat e Përgjithshme Teknike - Autoriteti Kroat i Rrugëve 2001)

Sigurinë e ekipit të mirëmbajtjes

- Legjislacionin mjedisor-Më poshtë shihni në materialin e nxjerrë informatat, specifikimet dhe standardet e prodhuesit. Informacioni i hollësishëm i Materialit dhe Prodhuesve mund të gjendet në Seksionin 5 dhe Shtojcën H të MOM.

2 .Struktura

Kullimi i urave kryhet nëpërmjet tubave me diametër 250 mm përgjatë urës të prodhuara nga Hobas në Gjermani dhe lidhen me sistemin e kullimit poshtë me kanal/përroskë (gully). Hollko nga Gjermania është prodhuesi i përroskës/Uje mbledhes(pusete). Formularët e materialeve janë të përfshira në dokumentet e dorëzimit.

Në rast të dëmtimi të betonit, Sika ishte përdorur si material riparimi. Sika ose materiale ekuivalente mund të përdoren për punimet e riparimit të betonit. Ju lutemi shihni Tabelën 4.

Parmakët metalikë dhe gardhet me tela janë prej çeliku të galvanizuar në të nxehtë në Trotualet dhe në ndarëset e betonit (Jersey Barriers).

Trotualet dhe ndarëset e betonit (Jersey barriers) janë beton i instaluar në llaç të injektuar.

Klasat e betonit për strukturat janë dhënë më poshtë. Klasat e ekspozimit duhet të jenë në përputhje me EN 206-1

Klasat e Betonit dhe Klasat e Ekspozimit

	Mbikalimet	Fortësi e Betonit	Klasa e ekspozimit	Vërejtje
1	Beton i varfer /blinding dhe jo-strukturor	C12/15	X0	
2	Shtylla me shpim/Bored pile	C25/30	XC2	
3	Mbështetja	C25/30	XC2	
4	Pllaka e qasjes	C25/30	XC2	
5	Syprinat e urës dhe muret e kthyer	C30/37	XC3, XD1, XF1	Nëse muri i syprinës së urës është afër autoudhës, do të përdoret klasa e ekspozimit XD3. Do të merret si referencë distanca 6 m nga korsia e ngadaltë tek muri i syprinës.
		C35/45	XC3, XD3, XF1	
6	Këmba e urës	C35/45	XC4, XD3, XF2	
7	Vatat peshëmbajtëse/Bearing pad	C35/45	XC1	
8	Superstruktura e mbikalimit	C30/37	XC3, XD1, XF1	
9	Trau i celikte i para-tensionuar i paraderdhur	C35/45	XC3, XD1, XF1	Jo në përdorim në Seksionin 1
10	Barriera kontrolluese betoni të paraderdhura	C35/45	XC4, XD3, XF4	
11	Beton anësor	C35/45	XC4, XD3, XF4	

Tabela 1

	Nënkalmimet	Fortësia e Beton.	Klasa e ekspozimit	Vërejtje
1	Beton i varfër	C12/15	X0	
2	Muret	C30/37	XC3, XD1	Për rrugë lokale
		C35/45	XC3, XD3	Për rrugë rajonale dhe kombëtare, muret e segmentit hyrës dhe dalës do të projektohen/dizenjohen për XD3

3	Pllaka e lartme (Catia)	C30/37	XC3, XD1	Për rrugë lokale
		C35/45	XC3, XD3	Për rrugë rajonale dhe kombëtare, pllaka e lartme (catia) e segmentit hyrës dhe dalës do të projektohen/dizenjohen për XD3
4	Muret anësore të urave	C30/37	XC4, XF1	>6m
		C35/45	XC4, XD3, XF1	Për rrugë rajonale dhe kombëtare, muret anësore do të projektohen për XD3 (<6m)
5	Themeli	C25/30	XC2	

Tabela 2

	Box Culvert	Fortësia e Beton.	Klasa e ekspozimit	Vërejtje
1	Beton i varfër	C12/15	X0	
2	Themeli	C25/30	XC2	
3	Muret	C25/30	XC2	Maksimumi i lejueshëm w/c është 0.50
4	Pllaka e lartme (Catia)	C25/30	XC2	Maksimumi i lejueshëm w/c është 0.50
5	Muret anësore-Themlet Hyrëse/Dalëse	C25/30 A	XC2/XF2	Maksimumi i lejueshëm w/c është 0.50

Tabela 3

Kuzhinetat Bearings dhe Nyjet e Zgjerimit

Seksioni C1A O068 6+858

O068 Pot Bearings Freyssinet:

- Pot Bearing EN udhëhequr TGe 2.2 4000/1200/135 Ngarkesa Vertikale maks.[kN] Ngarkesa Vertikale min. [kN] Ngarkesa horizontale e tërthortë [kN] Lëvizje gjatësore [+mm] x 2 Copë

-Pot Bearing EN lëvizje e lirë TGa 2.3 3000/135/20 Ngarkesa Vertikale maksimale[kN] Ngarkesa Vertikale minimale [kN] Lëvizje gjatësore [+mm] Lëvizje e tërthortë [+mm] x 2 Copë

O068 Nyjet e Zgjerimit Mageba:

-WD 160

Seksioni C1B O191 19+158

O191 Pot Bearings Freyssinet:

-Pot bearing EN udhëhequr TGe 2.2/2017/170/100 x 2 Copë

-Pot bearing EN lëvizje e lirë. TGe 2.3/2017/100/20 x 2 Copë

O191 Nyjet e Zgjerimit Mageba:

-Wosd për urë me kullim (SX 180)

Seksioni C2A O007 21+018

O007 Peshëmbajtëse elastomerike Mageba:

-300/400/83,5 – Tip V2 Mageba, peshëmbajtëse elastomerike EN lëvizje e lirë

O007 Nyjet e Zgjerimit Freyssinet International & CIE:

- Nyje Zgjerimi WoSd75

Seksioni C2A O021 22+414

O021 Peshëmbajtëse elastomerike Mageba:

- 400/500/148 – Tip C Mageba

O021 Nyjet e Zgjerimit Mageba:

- Nyje Zgjerimi Tip Modular LR 2

Seksioni C2A O106 30+910

O106 Peshëmbajtëse elastomerike Mageba:

- 300/600/112 – Tip C Mageba

O106 Nyjet e Zgjerimit Freyssinet International & CIE:

Nyje Zgjerimi WoSd100

Seksioni C2B O127 32+984

O127 Peshëmbajtëse elastomerike Mageba:

- 300/600/96 – Tip C

O127 Nyjet e Zgjerimit Freyssinet International & CIE:

Nyje Zgjerimi WoSd100

Seksioni C2B O144 34+680

O144 Peshëmbajtëse elastomerike Mageba:

- 300/500/112 – Tip C

O144 Nyjet e Zgjerimit Freyssinet International & CIE:

- Nyje Zgjerimi WoSd100

Seksioni C2B B167 36+980

B167 Peshëmbajtëse elastomerike Mageba:

- 350/450/121 – Tip C

B167 Nyjet e Zgjerimit Freyssinet International & CIE:

- Nyje Zgjerimi Wd160

Seksioni C2B B172 37+500

B172 Peshëmbajtëse elastomerike Mageba:

- 350/450/128 – Tip C

B172 Nyjet e Zgjerimit Freyssinet International & CIE:

- Nyje Zgjerimi Wd160

Detajet e Prodhuesit dhe Lista e Standardeve:

No	Document Number	Intended Category use of Material	Product Name	Description of Materials	Intended use of Material	Supplier Name	References
1	25939-000-QC-104-005	Concrete Repair	Sika Grouts	SIKA MONOTOP 620, SIKA MONOTOP 612, SIKA MONOTOP 610 Sika Monotop 621, Sika Grout 212, Sikadur 31F, Sika Grout 311, Sika Grout 314, Sika Grout 318, Sika Anchor Fix 2)	Hardened Concrete works and surface repairs	Sika	BS EN 1504-3
2	25939-000-QC-104-010	Concrete Repair	Water Bar	Sealing Material	Structural Expansion Joints	Sika	DIN V 18197
3	25939-000-QC-104-014	Concrete Repair	Polyurethane sealant material	SIKA Flex Construction	Polyurethane sealant material for rod clearance	Sika	ASTM C-794, ASTM C-920
4	25939-000-QC-104-016	Concrete Repair	Sikadur 31	Repair Mortar	Repair Mortar	Sika	EN 1504-4, BS 6319, AS 1478.2, EN 1542, ASTM C881-78
